



LAMTUMIRË O mik i vyer



Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

“Drita islame”
Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

DREJTOR
Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA
Erzen Carja

KONTAKT:
Tel/fax 04 223 04 092
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXXII i botimit
Nr. 04 (479)
Prill, 2023

ISSN 2226-7115



Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen,

nuk paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.

Materialet e sjella në redaksi,
pavarësisht nëse botohen apo jo,
nuk i kthehen autorit.

PËRMBAJTJA

4 Lamtumirë o mik i vyer / Mehmet Disha

6 Fitër bajrami / Dorian Demetja

10 Lajme / Aktivitete



14 Tebligu dhe Irshadi janë detyra e një besimtari / Haki Sahitaj

16 Zekati, sinqeriteti i bujarisë dhe i adhurimit / Sefer Bajraktari

18 Sahabët me radhë bëhen myslimanë me ftesën e të Dërguarit të Allahut

20 Bujaria e Profetit Muhamed (a.s.) / Dr. Faruk Vural

22 Domethënia e sadakasë së Fitrit / Salih Ferhat Hoxha

24 Zemra është peshorja e besimit / Elton Hazhi



28 Roli i hygjenes në fenë Islame / Ibrahim Hasnaji

30 Mytesim Këlliçi, Myfti, Kadi në Kavajë, Durrës e Tiranë / Nasuf Dizdari

32 Fëmijët dhe teknologjia / Omer Serranur

34 Retina, një mrekulli e krijimit / Aisa Kokiçi

38 Ndryshimi i njetit / Redaksia



Lamtumirë o mik i vyer



Muslimanët anë e kënd botës përfunduan këto ditë një nga adhurimet më të veçanta dhe më domethënëse të shoqërisë njerëzore, agjërimin e Ramazanit. Përfundoi një muaj përkushtimi e devocioni. Në mbarim të tij, gjendja e besimtarëve është e ndryshme. Disa i luten Allahut të Madhëruar që t'ua pranojë agjërimin dhe adhurimet e tjera, disa mërziën për largimin e tij, të tjerë gëzohen për realizimin me sukses të agjërimin dhe ardhjen e Bajramit.

Festat islame kanë një karakteristike të veçantë. Po të vërehet me kujdes, dy bajramet gjithmonë vijnë pas kryerjes së obligimeve madhore. Pas agjërimin ka festë, pas haxhit ka festë. Në qoftë se dikush duhet të festojë dhe të gëzohet, patjetër duhet të ketë një shkak. Shkaku pse muslimanët festojnë është më i veçanti dhe më real. Ata kanë mbyllur një muaj të mbushur me adhurime e përkushtime, e si çdo njeri që, në mbarim të punës, merr shpërblimin për punën e bërë, ashtu edhe muslimanët marrin shpërblimin nga Krijuesi i tyre për gjithçka të kryer për hir të Tij. Në lidhje me këtë transmetohet në një hadith kudsij se Allahu i Madhëruar ka thënë: "...agjërimi është vetëm për Mua dhe Unë shpërblej për të".

Duke qenë se jemi para një realiteti të pashmangshëm, përfundimit të Ramazanit, atëherë cilat janë detyrat tona për ditët në vijim? Mos vallë të gjitha obligimet dhe përkushtimet tona mbaruan këtu? Mos vallë bajramin do ta festojmë duke nxjerrë alkool për

vizitorët që na vijnë, apo duke lënë dhe namaze pa falur për hir të mysafirëve, ndërsa në Ramazan nuk linim të na humbte qoftë edhe një rekat teravi? Shembulli më i mirë për këtë është i dërguari i Allahut, Profeti Muhamed a.s. dhe shokët e tij. Për ata muaji i Ramazanit ishte burim frymëzimi për të shtuar veprat e mira. Mirësia e Ramazanit reflektohej në sjelljen dhe moralin e secilit prej tyre.


Bashkëshortja e Profetit Muhamed a.s., nëna jonë Aishja r.a., tregon: "Një natë më doli gjumi dhe shikoj se Profeti a.s nuk ishte në shtrat, por po falej, mirëpo, aq shumë kishte qëndruar në këmbë sa i dridheshin gjunjët. Kur përfundoi e pyeta: "O profet i Zotit, a nuk t'i ka falur Allahu të gjitha gabimet? Po - më tha, - por a nuk duhet të jem rob i Zotit falënderues?!"

Kjo ngjarje nuk ka ndodhur në Ramazan, por në një nga netët e zakonshme të vitit. Kur Profeti i Zotit vepronte në këtë mënyrë, po ne si duhet të veprojmë?

Tashmë jemi në ditët e muajit Sheval. Në një hadith të njohur Profeti Muhamed a.s. ka thënë: "Ai që e agjëron Ramazanin dhe agjëron (e pason me) gjashtë ditë të tjera nga muaji Sheval, është sikur të ketë agjëruar gjithë vitin."

Le të na shërbejë agjërimi i këtyre ditëve që secili prej nesh të fillojë reflektimin e Ramazanit që sapo kaloi e ta pasojmë edhe me adhurime të tjera, në mënyrë që ta meritojmë të quhemi pasues të denjë të traditës dhe shembullit profetik.

FITËR BAJRAMI



Çdo popull ka ngjarjet e veta historike të cilat i mban mend, i feston dhe i transmeton nga brezi në brez. Ato janë ditët e tubimeve masive, përkushtuar manifestimit të ndjenjave të tij kombëtare, shoqërore-politike apo fetare, me të cilat ndërton dhe përforcon ndërgjegjen ideologjike të shoqërisë së tij.

Kremtimi i festave në shumë popuj të botës, është shndërruar në formalitet, duke mos përfillur qëllimin e tyre moral dhe ngjalljen e ndjenjave humanitare. Në traditat e mira edukative të festës, infiltruan edhe shumë tradita të këqija, të cilat s'postuan të mirat dhe kështu festave u humbi qëllimi fisnik i kremtimit. Tekat e pakufishme në ushqim, në argëtim dhe në veshje luksoze, u sollën njerëzve më shumë dëm sesa dobi.

Edhe bashkësitë fetare kanë festat e tyre javore apo vjetore, të cilat i ringjallin ndjenjat e besimtarëve, u japin vull e forcë të re për jetën e tyre në vazhdim.

Kur Profeti a.s. emigroi në Medine vuri re se populli atje kremtonte dy festa në vit. Në ditët e festave organizoheshin lojëra e dëfrime të ndryshme. Kur pa këto Profeti a.s. tha: "Allahu i Lartë ka dhënë dy festa të tjera më të dobishme dhe më të bekuara se këto, Bajramin e Ramazanit dhe Bajramin e Kurbanit" (Nesai, Ibn Hiban, Et-Taxh, I, 309). Bajrami i Ramazanit nis me përfundimin e agjërimit njëmuor dhe vazhdon tri ditë. Ky quhet edhe Bajrami i Fitrit meqë gjatë muajit të Ramazanit jepet sadakaja e fitrit si detyrim falënderimi për arritjen e këtij muaji shëndoshë e gëzuar. Myslimanët përfundojnë në këtë festë gëzimin dhe lumturinë e agjërimit gjatë një muaji me radhë për hir të Allahut, e kapërcimit të vështirësive dhe të çuarjes në vend të urdhrit të Zotit Fuqiptotë. Bajrami i Ramazanit është i lidhur me përfundimin e suksesshëm të agjërimit dhe me fillimin e shpalljes së Kuranit, ndërsa Bajrami i Kurbanit me përfundimin e shpalljes së tij dhe me Haxhin. Të kremtuarit e këtyre ditëve na përkujton ditët e lavdishme të së kaluarës së ndritshme Islame dhe i inkurajon myslimanët për angazhime të mëtejshme, për detyra të reja dhe energji më të mëdha në organizimin dhe krijimin e një të ardhme më të mirë e më të lumtur.

Bajrami, festë e madhe për myslimanët

Dita e bajramit shëmbëllen në ditë paqeje dhe gëzimi. Vetë fjala "bajram" do të thotë gëzim, begati, kënaqësi, hare. Për këtë arsye, Profeti ynë i nderuar nuk lejonte që në faljen e namazit të bajramit të vihet me armë, qofshin ato edhe të thjeshta. Shokët e tij i porosiste që të mos i harrojnë të varfrit dhe nevojtarët. Kështu, myslimanët përpiqen që me Sadaka-i Fitr-in të plotësojnë nevojat e të varfërve dhe jetimëve që edhe ata të gëzojnë, sepse bajramet janë gëzimi jo i individit, por i shoqërisë, janë ndarja e këtij gëzimi mes njerëzve, janë hyrje në klimën e ndjenjave, janë mundësia që të gjithë myslimanët ta ndjejnë veten vëllezër. Nuk mund të mendohet që të ketë gëzim dhe kënaqësi bajrami për ata, që u kthejnë shpinën miqve, të afërmeve, fukarenjve dhe vëllezërve

të mbetur mënjanë. Në hadithin profetik thuhet: "Veprimi më i dashur për Zotin pas kryerjes së farzeve, është kur një mysli man e gëzon vëllanë e tij" (Sujuti, Xhamiu Sagir).

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të) na thotë gjithashtu se në bajrame duhet të tregohet gëzim e hare me qëllim që të manifestohet uniteti, toleranca, forca dhe vëllazërimi. Transmetohet se ai u thoshte njerëzve: "Në ditët e bajramit hahet, pihet dhe shkëmbehen vizita". Për këtë arsye i dërguari i Allahut a.s. e ka ndaluar agjërimin në këto ditë feste. Transmetohet nga Ebu Saidi: "Profeti ka ndaluar agjërimin në ditën e parë të Bajramit të Ramazanit dhe në ditët e Bajramit të Kurbanit" (Buhariu-Muslimu).

Dijetarët mysli manë, duke iu referuar shembujve të ndryshëm të jetuara në kohën e artë, kanë konkluduar që në ditët e bajrameve mund të dëfrehet me argëtime të shumëllojshme. Sigurisht që këto argëtime nuk duhet të kalojnë kriteret e lejuara të fesë sonë.

Festimi i Bajramit në trevat shqiptare

Në trevat tona bajramet janë festuar gjithmonë solemnisht. Bajrami ka lënë gjurmë të thella e të pashlyeshme te besimtarët shqiptarë edhe në çastet më kritike. Ai është freski për familjen, madje edhe besimtarët më të dobët bajramit i kushtojnë kujdes e rëndësi të veçantë.

Ditën e bajramit e gjithë familja ngrihet herët, marrin abdes, veshin rrobat më të bukura, lyhen me erëra të mira dhe shkojnë në xhami. Xhamitë mbahen të pastra, të aromatizuara dhe zbukurohen e ndriçohen si asnjëherë tjetër. Ndërkohë, rrugët kryesore të japin përshtypjen e një ditë festive duke qenë të mbushura me tullumbace, postera, banderola dhe banera që shprehin urimin e ditës së Bajramit. Pas namazit të bajramit, kudo, në qytete e fshatra, në lagje e në rrugë, të njohur dhe të panjohur takohen, përqafohen dhe urojnë bajramin me gjithë zemër njëri-tjetrit.

Në këtë ditë ndërmjetësohet për të pajtuar të zemëruarit, mëritë dhe armiqtë marrin fund, miqtë forcohen, të vegjëlvë u jepen dhurata, vizitohen të sëmurët, sepse kjo është dita e gëzimit dhe e lumturisë së përbashkët. Kremtimi i kësaj feste u jep mysli manëve një emocion të veçantë, një frymë të re, një zell të ri në punët e tyre fetare dhe të kësaj bote. Gjatë kësaj feste mysli manët japin shembullin më të bukur të bashkimit dhe unitetit islam.

Sigurisht, feja islame nuk është fe vetëm e trajtave dhe e ceremonive. Ajo mes trajtave praktike të caktuara, kërkon kuptime të thella e të larta dhe formon një shpirt fisnik. Në këtë mënyrë, bajrami i jep indikacion të qartë mysli manit se me besim të fortë dhe qëndrueshmëri permanente, mund të arrijë kontroll të përkryer mbi veten dhe të vendosë baraspeshë ideale midis materiales dhe shpirtërores.







1

SHPORTA E RAMAZANIT 2023 NË NDIHMË TË 2000 FAMILJEVE NË NEVOJË

Në prag të Muajt të Bekuar të Ramazanit, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, në bashkëpunim me Qendrën Bamirëse dhe Humanitare "Mbreti Selman" dhe Ambasadën e Arabisë Saudite në Tiranë, hapën fushatën e bamirësisë në ndihmë të mbi 2000 familjeve me vështirësi ekonomike në mbarë vendin tonë.

Fushata konsiston në shpërndarjen e pakove me ndihma të ndryshme ushqimore. Fillimisht pakot me nga 67 kg ushqime secila, do t'ju dorëzohen përfaqësuesve të KMSH-së në 34 rrethe të vendit, më pas këta të fundit do t'jua shpërndajnë familjeve në nevojë.

Ceremonia e lançimit të kësaj nisme u zhvillua në ambientet e Medresesë së Tiranës.

Të pranishëm ishin nënkryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Z. Tauland Bica, z. Fajsal Gazi Hifdhi, ambasadori i Arabisë Saudite në Tiranë, Abdulkerim Al Jusuf, përfaqësues i Qendrës Humanitare "Mbreti Selman" dhe z. Edison Hoti, drejtor i Vokf-Investimeve në KMSH.





2

VIZITË ZYRTARE E SEKRETARIT TË SELISË SË SHENJTË PËR MARRËDHËNIET ME SHTETET DHE ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një vizitë zyrtare Sekretarin e Selisë së Shenjtë për Marrëdhëniet me Shtetet dhe Organizatat Ndërkombëtare, Arqipeshkvin Paul Richard Gallagher.

Sekretari i Selisë së Shenjtë vlerësoi lart kontributin që jep KMSH në kuadër të harmonisë dhe bashkëjetesës. Ai përmendi gjithashtu edhe rëndësinë e vizitës së fundit të z. Spahiu në Vatikan dhe audiencën e veçantë me Papa Françeskun.

Nga ana e tij kryetari Spahiu e njohu Gallagher me strukturën dhe veprimtarinë e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Duke qenë edhe në vitin e krenimit të 100-vjetorit ai bëri edhe një rezumë të përgjithshme të 100 viteve të institucionit, sfidat dhe arritjet gjatë këtij shekulli.

Kryetari e informoi Sekretarin Richard Gallagher edhe për kryesimin e Presidencës së Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë në kuadër të të cilin u zhvillua edhe takimi me KNFSH në selinë e KMSH më pas.





3

AGJËRIMI DHE NJERIU (NDIKIMI I AGJËRIMIT NË JETËN INDIVIDUALE DHE SOCIALE TË NJERIUT)

Zhvillohet konferenca a parë shkencore me titull: "Agjërimi dhe Njeriu (Ndikimi i agjëritimit në jetën individuale dhe sociale të njeriut)", organizuar nga Instituti i Studimeve Islame "H. Sabri Koçi" në bashkëpunim me Departamentin e Shkencave Islame në Kolegjin Universitar "Bedër".

Në ceremoninë e hapjes, e cila u zhvillua në sallën e konferencave të këtij institucioni arsimor, ishin të pranishëm Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Përgjegjësi i Departamentit të Shkencave Islame në Bedër, z. Jamal al-Safarti, Nënkryetari i KMSH-së, z. Taulant Bica, akademikë të shumtë, studiues, myftij, imamë, si dhe një numër i konsiderueshëm studentësh.

Pas fjalëve përshëndetëse, konferenca u zhvillua më tej në 3 sesione të ndryshme, në të cilat referuesit sollën në fokus aspekte nga më të ndryshmet të agjëritimit, përmendim këtu: "Dobitë e agjëritimit në planin shpirtëror dhe moral", "Dimensioni social i agjëritimit", "Jurisprudenca e agjëritimit", "Ramazani dhe fëmijët", "Aspekti shëndetësor i agjëritimit", "Gruaja myslimane Shqiptare në Ramazan", "Agjërimi, parandaluesi i mëkateve", etj.

4

KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË SHTRON IFTARIN E PARË TË KËTIJ RAMAZANI

Me datë 23.03.2023, në ambientet e "Tirana International Hotel", Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, shtroi iftarin e parë, iftar në të cilin morën pjesë besimtarë të shumtë, myftij, imamë, personalitete publike, ambasadorë, gazetarë, politikanë, zyrtarë qëndror, lokal etj. veçojmë këtu Presidentin e Republikës së Shqipërisë, Shtz. Bajram Begaj.

Në fjalën e tij të rastit, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, pasi falenderoi të pranishmit për pjesëmarrjen dhe ju uroi agjërim të lehtë e të pranuar tek Allahu (xh.sh) të gjithë besimtarëve, u ndal në vlerat morale e shpirtërore që kultivon ky muaj i begatë tek të gjithë ne.

Të pranishmit i përshëndeti gjithashtu edhe Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Begaj, i cili shprehu kënaqësinë e tij që këtë vit i bashkohet tryezës së iftarit të parë, të kthyer tashmë në traditë nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë.





5

BESIMTARËT MYSLIMANË FESTOJNË FITËR BAJRAMIN

Në kuadër të 100-vjetorit të themelimit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, në ambientet e "Tirana International Hotel" u zhvillua aktiviteti i radhës me titull "100-vjet KMSH", ku ishin të pranishëm myftijtë e çdo qyteti, anëtarë të Këshillit të Përgjithshëm, imamë dhe kryesia e institucionit.

Ky takim u çel me leximin e disa ajeteve të Kuranit Famëlartë nga Drejtori i Arsimit e njëkohësisht imami i xhamisë "Et'hem Beu", z. Elton Karaj, më tej programi vijoi nën moderimin e Nënkrjetarit të KMSH-së, z. Taulant Bica.

Pasi bëri një rezymë të shkurtër rreth historikut të themelimit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe i njohu të pranishmit me programin e aktivitetit, z. Bica, ia kaloi fjalën për përshëndetjen e rastit Kryetarit, H. Bujar Spahiu.

Në fjalën e tij, ai u ndal në sfidat kryesore që ka kaluar institucioni në këto 100 vite për të cekuar më pas edhe kontributin e gjithësecilit në mbarëvajtjen e aktivitetit fetar, kulturor e social në çdo myftini të vendit.

"Besimtarët myslimanë shqiptar kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në përçimin e mesazhit të bukur të islamit ndër vite dhe kanë qenë aktorë me rol të veçantë në çështjen kombëtare. Këtë kontribut e keni pasuar me shumë seriozitet edhe ju të nderuar myftij. Andaj, gjej rastin t'ju falenderoj përzëmërsisht për punën tuaj të palodhshme në vazhdimësinë e misionit dhe vizionit të këtij institucioni" – u shpreh Kryetari Spahiu gjatë fjalës së tij.

Pas fjalës së kryetarit, të pranishmit ndoqën dokumentarin historik të përgatitur me rastin e këtij viti jubile.

Aktiviteti vijoi më tej në formën e diskutimeve të lira mes të pranishmëve.



TEBLIGU DHE IRSHADI JANË DETYRA E NJË BESIMTARI

Në një ajet lidhur me temën e tebligut (kumtimit) dhe irshadit (udhëzimit), Zoti ynë na paralajmëron me shprehjet e mëposhtme: “Besimtarët dhe besimtare janë miq për njëri-tjetrin: urdhërojnë që të bëhen vepra të mira, e pengojnë të këqiat, falin namazin, japin zeqatin, dhe i përulen Perëndisë dhe Pejgamberit të Tij. Këta janë ata që do t’i mëshirojë Perëndia. Se, Perëndia me të vërtetë, është i Plotëfuqishëm dhe i Gjithëdjshëm.”¹

Në ajet përshkruhet si detyrë e besimtarit që besimtari ta urdhërojë bashkëbesimtarin për të mirën dhe ta ndalojë nga e keqja. Kjo përgjegjësi përshkruhet në ajet si një karakteristikë e pandashme e të qenit besimtar.

Pse është kaq e rëndësishme kjo detyrë? Sepse të qenit një shoqëri paqësore varet nga largimi i njerëzve nga të gjitha llojet e të këqijave. E keqja është si një virus. Nëse ky virus nuk ndërhyhet në kohë, ai përhapet në organizëm dhe e paralizon organizmin. Të këqijat që shkaktuan shkatërrimin total të shoqërive u formuan nga përhapja e mëkateve që dukeshin të vogla në fillim.

1 Shih surja Tevbe, 9/71.

Shihni se si Pejgamberi e tërheq vëmendjen ndaj këtij rreziku në një hadith:

“Kolapsi social filloi te izraelitët kështu: Një person thoshte: “O filani, lëre këtë punë, nuk të lejohet të veprosh kështu”, për të keqen që pa tek ai person. Të nesërmen vinte dhe vazhdonte miqësinë me të, edhe pse ai njeri po bënte të njëjtin mëkat, ulej me të dhe pinte bashkë. Më pas, Allahu (xh.sh.) i krahasoi zemrat e tyre me njëra-tjetrën.”

Më pas Pejgamberi (a.s.) vazhdoi:

Duke lexuar ajetin “U mallkuan ata nga bijtë e Israelit që ishin mohues, me gjuhën e Davudit dhe të Isait – të birit të Merjemës, për shkak se ishin të padëgjueshëm dhe ngase kishin kaluar kufirin: njëri-tjetrin nuk e pengonin nga veprat e këqija që punonin. E, sa të shëmtuara ishin veprat që punonin ata!”² ai tha: “Jo, pasha Allahun, patjetër duhet të urdhërosh të mirën dhe ta ndalosh mëkatarin dhe patjetër duhet ta marrësh

2 Surja Mâide, 5/78-79.



dorën e zullumqarit dhe ta çosh te kufiri i së vërtetës.”³

Këtu, ndërkohë që shprehet gjendja e disa izraelitëve, të cilët lejojnë të keqen, besimtarët paralajmërohen për të njëjtin rezultat dhe paralajmërohen që të mos bien në një situatë të tillë. Prandaj, nga këtu mund të thuhet se kumtimi dhe udhëzimi shërbejnë si rrufepritës kundër shkatërrimit të shoqërive. Në fakt, nëse detyra e “emr bil’l-ma’ruf ne vehji ani’l-munker/urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja” kryhet në një bashkësi, Allahu nuk do ta shkatërrojë atë bashkësi.

Duke shpjeguar këtë çështje në një nga hadithet e tij, Profeti thotë: “Shembulli i atyre që ndjekin urdhrat e Allahut dhe atyre që nuk i zbatojnë është si shembulli i atyre që udhëtojnë në të njëjtën anije. Disa prej tyre janë lart dhe disa janë në katin e poshtëm. Nëse ata që janë në fund duan të marrin ujë që të mos shqetësojnë vëllezërit e tyre, nëse përpiqen të hapin një vrimë në fund të anijes, duke u thënë atyre lart, që ne të hapim një vrimë në vendin tonë, dhe nëse njerëzit lart e lejojnë këtë situatë, të dyja palët do të detyrohen të fundosen.”⁴

Në fakt, këto thënie të të Dërguarit të Allahut janë shembull. Këtu, Profeti ynë shpreh si shembull një çështje shumë serioze shoqërore dhe e shpreh atë sipas nivelit tonë të të kuptuarit. Dëshirat e atyre që duan të shpojnë anijen këtu mund të duken të pafajshme në shikim të parë. Por rezultati që do të dalë nuk është aspak i pafajshëm.

Në bazë të këtij hadithi mund të thuhet se bota është një anije, ose trageti, si anija e Nuhut (a.s.). I gjithë njerëzimi është në atë anije pa asnjë zgjedhje. Sepse të gjithë në këtë botë duhet të jetojnë në të njëjtën tokë. Me fjalë të tjera, trageti ku jetojmë dhe udhëtojmë së bashku është një dhe nuk ka të dytë. Është detyra jonë të mbrojmë anijen në të cilën ndodhemi dhe ta mbrojmë atë nga fundosja. Kjo detyrë është një detyrë që na është vënë mbi supë me hipjen tonë në këtë traget.

Nga njëra anë, duhet të eliminojmë të këqijat në shoqëri, të këqijat në formën e gjarpërinjve dhe insekteve helmues⁵, dhe të mbrojmë njerëzimin nga e keqja e tyre, nga ana tjetër, duhet të pajisim të njëjtën shoqëri me tipare të mira dhe sjellje të virtytshme, që ne e quajmë ma’rûf. Në çdo rast, shoqëria e formësuar, edukuar nga natyra e pastër është e lirë nga të gjitha llojet e të këqijave. Megjithatë, ky është një aspekt i çështjes; Sa i përket aspektit tjetër, është që gjithmonë të sigurohemi që gjërat e mira të zhvillohen dhe të lulëzojnë në shoqëri. Kjo është detyra që kemi marrë përsipër për shoqërinë tonë. Kjo detyrë është e shenjtë, për aq sa është e shenjtë është e rëndë dhe e vështirë.⁶

**Nga turqishtja Haki Sahitaj
8 mars 2023**

3 Ebû Dâvûd, Melâhim, 17; Ibn Mâxhe, Fiten 20.

4 Buhârî, Sherike 6.

5 Në origjinal ‘çıyan, pra që është fjala për një insekt helmues njëqindkëmbësh, dyzetkëmbësh që në zoologji njihet me emrin Scolopendra (Përkthyesi H. S).

6 Fethullah Gülen, İrşad Ekseni, fq. 69-70.

Zekati, singëriteti i bujarisë dhe i adhurimit

Zekati është e drejta e parë dhe kryesore prej të drejtave të Zotit, dhe është më dobiprurësja për njerëzit mes këtyre të drejtave. Zekati, që myslimanit i është bërë obligim, ka për qëllim që secili besimtar të pastrojë pasurinë e tij nga pjesa që i takon të varfërve dhe nevojtarëve. Këtë të drejtë i pasuri duhet ta japë me dëshirë në qoftë se dëshiron të patrojë dhe sigurojë pasurinë e tij, në qoftë se dëshiron të shpëtojë nga fatkeqësitë në këtë jetë dhe të fitojë Xhenetin në botën tjetër.

Fjala zekat do të thotë pastrim ose në një kuptim të dytë do të thotë shtim. Nga vetë kuptimi që ka fjala zekat, për besimtarin është fare e qartë se duke dhënë zekatin, i pasuri siguron pasurinë e tij dhe njëkohësisht beson Allahu do t'ia shtojë dhe më shumë. Për besimtarin mysliman dhënia e zekatit është detyrë e jo dëshirë. Në Kuran shprehimisht thuhet: "Jepuni të afërmeve, të varfrit dhe udhëtarit të drejtën e tyre, por mos bëni shpenzim të tepruar" (Isra, 26). Ky urdhër i Kuranit fare qartë sqaron besimtarin e pasur se të afërmit e tij që jetojnë në varfëri dhe të vobektët kanë pjesën e vet në pasurinë e gjithsecilit dhe kjo u duhet dhënë atyre. Në një ajet tjetër kuranor Allahu (xh.sh.) thotë: "As pasuria juaj, as fëmijët tuaj nuk do t'ju afrojnë më shumë të Ne, por vetëm ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira (e meritojnë këtë)" (Sebe, 37)

Nga ajeti i sipërcituar ne shohim se menjëherë pas besimit në një Zot vlerësohen veprat e mira, gjë kjo që përforcon besimin dhe na mundëson që t'i afrohem gjithnjë e më tepër mëshirës së Zotit. Të shpenzosh nga pasuria për

të mirën e përgjithshme është një nga detyrat kryesore për çdo mysliman. Kjo kryhet në dy mënyra: me detyrim dhe me vullnet. Zekati për të cilën folëm është një masë e detyrueshme që përdoret në dobi të njerëzve të varfër dhe në ngritjen e veprave kulturore të dobishme që i shërbejnë mbarë shoqërisë si: ndërtimi i xhamive, bibliotekave, shkollave, rrugëve, ujësjellësve e çdo veprë tjetër në dobi të shoqërisë. Allahu u premton besimtarëve se sa më shumë të shpenzojnë për vepra bamirëse aq më shumë u shtohet pasuria dhe mirëqenia e tyre. Në Kuranin e madhërueshëm thuhet: "Ata që shpenzojnë pasurinë e vet në rrugë të Allahut, i shëmbëlajnë atij që mbjell një kokërr nga e cila dalin shtatë kallinj, ku secili kallë ka njëqind kokrra. Allahu ia shton (shpërblimin) edhe më tepër kujt të dëshirojë; Allahu është Mirëbërës i madh dhe i Gjithëdijshëm." (Bekare, 261)

Kështu myslimani zekatin e jep me dëshirë. Ai ka besim të plotë në premtimin e Allahut që pasuria e tij jo vetëm nuk pakësohet, por do t'i shtohet gjithnjë e më shumë në saje të punës që ai bën. Për besimtarin mysliman dhënia nga pasuria e tij nuk kufizohet vetëm me zekatin. Ai do të shpenzojë nga pasuria e tij çdo herë që ta shohë të nevojshme për të zgjidhur problemet e jetës për njerëzit që e rrethojnë dhe shoqërinë ku jeton.

Tanimë edhe ndër ne është bërë traditë dhënia e Sadakai Fitrit me mbarimin e muajit të madhërueshëm të Ramazanit, prerja e kurbanit për Bajram dhe shpërndarja e mishit për të varfrit e nevojtarët.

Zekati e detyron myslimanin të mbajë llogari të pastra e të



rregullta pasi një llogari e rregullt të informon me saktësi mbi detyrimet që ke ndaj Allahut dhe shoqërisë për të shpenzuar nga pasuria jote për realizimin e zekatit. Nuk kemi ndër mend, në këtë shkrim, të sqarojmë me hollësi se si duhet llogaritur dhënia e zekatit. Duam vetëm t'i kujtojmë lexuesit se zekati jepet për çdo vit, në masën 2.5 % ose 1/40 të pasurisë. Zekati është një sakrificë e detyrueshme për çdo mysliman që zotëron njëfarë pasurie. Myslimani duhet të skarifikojë për të siguruar lumturinë e njerëzisë, dhe këtë e bën nëpërmjet zekatit. Në këtë mënyrë vëllazëria islame nuk lë shkak për grindje në mes njerëzve.

Dikush mund të pyesë: "Pse u dashka të jepet zekati për çdo vit? Pikërisht kjo është një e mirë tjetër që Islami u dhuron njerëzve (shoqërisë në përgjithësi). U vë detyrë që çdo njeri kapitalin (paratë) të mos e mbajë të mbyllyr në kasafortë dhe vetë të rrijë pa punë. Kapitali i vdekur dhe që nuk qarkullon është veprim i ndaluar në Islam. Në Kuranin Famëllartë thuhet: "...ata që grumbullojnë ar dhe argjend dhe nuk e shpenzojnë për hir të Allahut, paralajmëroji me dënim të dhembshëm." (Teube, 34)

Nga sa përmendëm deri këtu për zekatin, kuptohet fare mirë se po të zbatohen me përpikëri mësimet e Kuranit në mirëpërdorimin e pasurisë, shoqëria njerëzore në përgjithësi do të jetojë e lumtur e pa grindje.

Dhënia e zekatit eliminon në maksimum ndarjet, krijon harmoni e dashuri mes njerëzve, njëkohësisht ndihmon dhe përparimin e zhvillimin e shoqërisë islame për t'u bërë shembull në tërë botën.

Zekati është detyrë për çdo mysliman kudo që të jetojë. Dhënia e tij e bën myslimanin e pasur që me veprat e tij të bamirësisë të fitojë dashurinë, respektin e njerëzve që jetojnë në varfëri. Krahas kësaj edhe institucionet fetare duke filluar nga Komuniteti Mysliman e myftinitë të mendohet mundësia që nga myslimnaët e devotshëm të ngrihen shoqata bamirëse të cilat të kenë statutin e tyre për të mbledhur zekatin e ndihma të tjera e për t'i përdorur ato në dobi të shtresave të varfra.

Nga sa thamë më sipër, ndonjë person i pasur mund të mendojë se Islami kërkon vetëm të kryhen vepra bamirësie dhe si ai vetë në familjen e tij nuk paska asnjë të drejtë të gëzojë të mirat që i ka dhënë Zoti. Një mendim i tillë as që mendohet të ekzistojë te besimtari se vetë Zoti në Kuranin e madhërueshëm thotë: "Thuaj: - Kush i ka penguar stolitë dhe ushqimet e këndshme, të cilat Ai i ka krijuar për robërit e Vet?" "Thuaj: - Ato janë për besimtarë (dhe të tjerët) në këtë botë, ndërsa në botën tjetër do të jenë vetëm për besimtarët..." (Araf, 32)

Kështu duhet kuptuar zekati, i cili bashkë me shërbimet e mëdha që i sjell shoqërisë duke siguruar paqen sociale, e përgatit myslimanin me një dashuri të madhe për Zotin që e mundëson të jetojë në mes të gjithë të mirave e njëkohësisht të kryejë vepra bamirësie në dobi të njerëzve dhe shoqërisë ku jeton.

SAHABËT ME RADHË BËHEN MYSLIMANË ME FTESËN E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT

Si u bë mysliman Osmani (r.a.)

Osmani (radjallahu anhu) na tregon: "Një ditë pata shkuar për vizitë te teza ime, Abdulmuttalib binti Eruaja. Kur, ç'të shoh, brenda hyri i Dërguari i Allahut. Vazhdimisht nuk i ndaja dot sytë prej Tij. Atë ditë diç duhej t'i kishte ndodhur. U kthye nga unë dhe më pyeti:

- "Pse më shikon ashtu?"

- "Habitem kur shoh personalitetin tuaj, vendin që zini ju këtu mes nesh dhe ato që thuhet për ju?!", - iu përgjigj Osmani.

- "La ilahe il'Allah.", - tha Ai.

Të më besoni, por kjo fjalë e tij bëri të më rrëqetehj i tërë trupi. Mandej më lexoi prej këtij ajeti: "Në Tokë ka shenja për ata që besojnë me bindje, po edhe në vetet tuaja - a nuk e shihni vallë? Në qiell është furnizimi juaj dhe gjithçka që ju është premtuar. Betohem për Zotin e qiellit dhe të Tokës, se kjo (që ju premtohet) është e vërtetë, ashtu siç është të folurit tuaj." (Dharijat, 51/20-23). Kur mbaroi, u largua së andejmi. Unë e ndoqa nga pas, gjersa e arrita dhe u bëra mysliman.¹

Si u bë mysliman Aliu (r.a.)

Familja e Ebu Talibit ishte një familje shumë e madhe dhe Ebu Talibi e kishte shumë të vështirë që të kujdesej për mbajtjen e të gjithë atyre njerëzve. Andaj, Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) e pati marrë Aliun (radjallahu anhu) në shtëpinë e tij, duke bërë që ai të ishte një fëmijë i shtëpisë së Tij deri në ditën kur i erdhi profetësia. Më vonë, një ditë, i Dërguari i Allahut dhe bashkëshortja e vyer e tij, nëna jonë, Hatixhja (radjallahu anha) po falnin namaz. Pikërisht në ato çaste, teksa ishin duke u falur, Aliu i nderuar hyri në shtëpi dhe i habitur i pyeti:

- "Çfarë po bëni kështu ju?" I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) iu përgjigj:

- "Kjo është feja që ka zgjedhur Ai që është Zoti i botëve, për të cilën edhe ka dërguar profetë. Unë të ftoj edhe ty që t'i besosh Allahut, i cili është i Vetëm dhe nuk ka shok, që ta adhurosh atë dhe të heqësh dorë nga idhujt e Latit dhe Uzzas, duke i mohuar ata."

- "Kjo është diçka që nuk e kam dëgjuar kurrë më parë, dhe unë nuk mund të vendos me mendjen time për diçka të këtillë. Me lejo që të këshillohem njëherë me babanë." Profeti ynë, duke qenë se nuk i kishte zbritur ende asnjë urdhër që ai ta shpallte fenë e Allahut haptazi, nuk deshë që kjo çështje të shkonte deri tek Ebu Talibi, ndaj e porositi:

- "O Ali! Edhe pse mund të të duhet pak kohë për t'u bërë mysliman, të mos e bisedosh me askënd këtë çështje!"

Të gjithë natën e asaj dite Aliu e kaloi duke menduar për atë që kishte dëgjuar. Kështu, Allahu i mundësoi edhe atij udhëzimin për tek e drejta dhe e vërteta. Në mëngjes, me të gdhirë, ai shkoi pranë të Dërguarit të Allahut dhe e pyeti:

- "Çfarë ishte ajo që më pate këshilluar dje?"

- "Do të dëshmosh se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Ai është Një i Vetëm dhe që nuk ka shok në krijim dhe në adhurim. Do t'i mohosh idhujt e Latit dhe Udhas dhe do t'i qëndrosh larg çdo lloji të idhujtarisë.", - iu përgjigj Profeti ynë.

Aliu (radjallahu anhu) ishte gati për një gjë të këtillë, ndaj edhe u bë menjëherë, në atë çast, mysliman. Por, i shqetësuar se çfarë do të mendonte i ati, për njëfarë kohe ai e fshehu besimin e tij.² Më vonë, Ebu Talibi i pati parë ata duke falur namaz, por nuk u pati thënë asgjë.

Si u bë mysliman Amr bin Abeseja

Tregon vetë Amr bin Abeseja: "Në kohën e injorancës, më ndodhte mjaft shpesh që t'i shikoja njerëzit që jetonin një jetë krejtësisht të ç'udhëzuar dhe besoja se prej atyre idhujve që u besonin njerëzit nuk kish se si të vinte asnjë e

¹ Ibni Abdi'l-Berr, el-Istiah 4/225.

² Ibni Kethir, el-Bidaje 3/24.



mirë. Kur dëgjova se në Mekë kishte dalë dikush, që fliste për disa lajme shumë të rëndësishme, i hipa menjëherë kafshës sime të rrugës dhe erdha në Mekë. Në atë kohë i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) nuk e kishte nisur ende shpalljen haptazi të fesë. Megjithatë, lajmi i profetësisë kishte filluar të përhapej e të shëtiste nga njëri vesh në tjetrin mes qytetarëve të Mekës. Andaj edhe mekasit e kishin rrethuar atë, për ta mbajtur nën kontroll, në mënyrë që të mund ta pengonin me çdo kusht, nëse ai do të vendoste të bënte ndonjë veprim haptas. Dhe unë, duke u treguar sa më i kujdesshëm që gjithçka të ndodhte në fshehtësi, shkova drejt e tek i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), pa pyetur njeri dhe iu drejtova atij me këto fjalë:

- "Kush jeni ju?", - e pyeta.
- "Unë jam Profeti i Allahut.", - m'u përgjigj ai.
- "Çfarë do të thotë 'i Dërguar i Allahut'?"
- "I Dërguari i Allahut do të thotë të jesh mëkëmbës i Tij, që vjen pranë njerëzve për të sjellë urdhëresat që ka Zoti ndaj njerëzve."

- "Domethënë, Ty të ka dërguar Zoti!?"
- "Po, mua më ka dërguar Zoti.", - m'u përgjigj i Dërguari i Allahut.

- "E çfarë na ke sjellë ti prej Zotit?"
- "Allahu do të njihet si Një i Vetëm, nuk do t'i bëhet asnjë shok ose ortak në krijimin e gjithçkaje; idhujt që adhurojnë njerëzit do të thyhen dhe ne duhet të kujdesemi për më të mirën e të afërmve tanë dhe t'ua ruajmë atyre të drejtat që ata kanë, duke mos derdhur as edhe një pikë gjaku të vetme padrejtësisht dhe të gjithëve do t'u sigurohet që të mund të udhëtojnë të sigurt."

- "Po Ti na paske sjellë gjëra shumë të bukura! Unë jua shpall menjëherë këtu besimin tim. Unë të pranoj ty. Kush i ka pranuar deri më tani të gjitha këto urdhëresa që ti i ke sjellë prej Zotit për ne?"

- "Ebu Bekri dhe sklavi i tij, Bilal Habeshiu."

- "Unë dua të jem një prej ndjekësve të tu."
- "Sot, kushtet nuk janë shumë të vështira që ti të jesh një prej ndjekësve të mi këtu në Mekë, andaj më e mira është që tani të kthehesh pranë familjes sate dhe kur të shohësh se unë do të kem filluar që ta shpall haptazi fenë e Allahut dhe se e vërteta po fillon të dalë faqeza, atëherë eja."

Amri tregon: "Unë u bëra mysliman dhe u ktheva pranë familjes sime. I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) nisi ta shpallte haptazi të vërtetën. Mandej ai mërgoi për në Medinë. Merrja vazhdimisht lajme për të. Në fund, nga Medina erdhi një grup që e kishte nisur ai vetë. Në një mënyrë të tërthortë, i pyeta:

- "Ç'thonë ata mekasit që janë strehuar pranë jush?"
- "Në fund, populli i tij deshi që ta vriste atë, por ata nuk ia dolën dot. Allahu nuk lejoi që të ndodhte diçka e këfillë. Ndaj kemi ardhur edhe ne, se njerëzit po ngarendin për t'i shpallur atij besimin dhe mbështetjen.", - m'u përgjigjën ata mua.

Amr bin Abeseja, me t'i dëgjuar këto fjalë, u hodh mbi kafshën e tij dhe u nis me shpejtësi për në Medinë. Shkoi pranë Krenarisë së Gjithësisë dhe e pyeti:

- "O i Dërguari i Allahut! A më njohët mua?"
- "Po!", - m'u përgjigj i Dërguari i Allahut, - "ti je ai njeri që pate ardhur të bëheshe ndjekësi im që kur se ne ishim ende në Mekë, apo jo?"

Aty Amr bin Abeseja gati sa s'fluturoi nga gëzimi, duke thënë:

- "Po, o i Dërguari i Allahut! M'i mësoni, ju lutem, të gjitha ato gjëra që Zoti jua ka mësuar ju dhe që unë nuk i di."³

3 Ibn Abdil-Berr, el-Istiab 4/225.

BUJARIA E PROFETIT MUHAMED (A.S.)



"Kerem" do të thotë bujari, bamirësi dhe gostitje. Në arabisht "kerem" është një virtut i pëlqyer. Madje kur analizojmë poezitë e periudhës para Islamit, mund të shihni se arabët e asaj periudhe janë lavdëruar në këto pika: Ne premë kaq dele, kaq lopë dhe kaq deve / dhe ia servirëm mysafirëve. Gostitja me bujari e mysafirrit ishte shkak për t'u lavdëruar dhe në këtë pikë fiset bënin gara me njeri-tjetrin. Sigurisht që ata e bënë çdo gjë në emër të egoizmit të tyre. Në një kohë kur mes tyre vlerësohej bujaria dhe bamirësia, u shfaq një njeri, më bujari mes bujarëve. Të gjithë shtangën kur panë bujarinë e tij. Ky njeri bujar, gjithçka e bënte për hir të Zotit dhe nëse i dhuronte dikujt botën, nuk fliste as dhe një fjalë për të. Madje dhe poezitë e poetëve që tregonin për bujarinë e Tij, nuk i pranonte në asnjë mënyrë dhe fjalët e tyre ia dedikonte Zotit, "Ekremul Ekremi" Më Bujari i Bujarëve.

Ai ishte një pasqyrë e ndritshme në të cilën pasqyrohej dhe dëshmonte veten emri i Zotit "Kerim". Ashtu si në çdo fushë tjetër, edhe në këtë fushë, Profeti Muhamed (paqja qoftë mbi të!) ishte përfaqësuesi më i lartë i Zotit të Madhëruar. Dhe nuk mund kishte njeri më bujar së ai mbi tokë. Nëse bujaria merret si një normë morale që të afron me Zotin, si të mos ishte bujar i Dërguari i Zotit? Dhe pikërisht ai shprehet me këto fjalë: "Bujari është afër njerëzve, afër xhenetit dhe larg xhehenemit. Ndërsa koprraci është larg njerëzve, larg xhenetit dhe afër xhehenemit."¹

Në jetën e tij personale ai kishte zgjedhur varfërinë. Kjo nuk do të thotë se ai dëshironte që të gjithë të ishin të varfër. Por në të njëjtën kohë nuk i pëlqente njerëzit e fryrë dhe përherë me mendjen tek stomaku. Me mësimet e tij, myslimanët u bënë populli më i pasur në botë për një kohë të shkurtër. Nuk gjenin njerëz mes tyre të cilëve t'u jepnin sadakanë dhe zekatin. Aq të larta ishin të ardhurat personale të një personi! Por mes tyre kishte dhe aq njerëz modestë, saqë në shtëpi mbanin ushqimet ditore dhe nuk pranonin diçka tjetër që mund t'u jepej. Ky është një altruizëm dhe çështje e lartësisimit shpirtëror. Është dashuria për të dhuruar jetë. Nuk është i mundur kuptimi i këtyre gjërave nga njerëz të cilët s'janë mbushur me këto ndjenja.

Në një hadith të transmetuar nga Ibn Abasi, ai tregon për bujarinë e Profetit: "I Dërguari i Zotit ishte njeriu më bujar ndër njerëz. Kur vinte muaji i Ramazanit dhe takohej me Xhebrailin, bëhej edhe më bujar. Xhebraili vinte çdo natë dhe përsëriste Kuranin bashkë me të. I Dërguari i Zotit ishte dhe me bujar se era që fryn."²

Profeti ynë, me urdhrin e Zotit, mbante një të pestën e të gjithë pasurive. Autorizimin për të përdorur pasurinë sipas dëshirës ia kishte dhënë drejtpërdrejt Zoti i Madhëruar. Megjithatë, Omeri (r.a) do të hynte një ditë në dhomën e tij të lumturisë dhe do të qante me dënësë. Kur Profeti e kishte pyetur se çfarë kishte, Omeri i madh ishte përgjigjur kështu:

1 Tirmidhiu, 4/342

2 Buhari, 2/672, 3/1177; Muslimi 4/1803; Nesai, 4/125

"O i Dërguari i Zotit! Mbretërit e botës po notojnë në mes të pasurisë. Ndërsa ti nuk ke as dhe një shtrojë për t'u ulur... shtratin e ke prej rrogozi dhe në fytyrë shenjat e tij..."

I Dërguari i Zotit i përgjigjet kështu: "A nuk dëshiron, o Omer, që Ahireti të jetë i yni dhe kjo bota e tyre?"³ Kur Profeti fliste kështu, nuk fliste me fjalët e një të varfri i cili nuk ka mundësi të jetojë ndryshe, apo me fjalë që pasqyrojnë dëshpërim, vuajtje të një njeriu. Siç e theksuam më sipër, po të dëshironte, mund të ishte njeriu më i pasur.

Butësia dhe çelësat e ndjenjave të tjera hyjnore të Profetit (paqja qoftë mbi të!) kanë hapur shumë zemra të mbyllura. Pavarësisht nevojave të tij, ai jepte gjithçka që i kërkohej. Sehl bin Sad transmeton: Një ditë, një grua i solli Profetit një triko të punuar vetë.

O i Dërguari i Zotit! Këtë triko e kam punuar me duart e mia dhe desha t'ju dhuroj, - iu drejtua gruaja. Profeti kishte nevojë për një triko. Dhe e ka veshur trikon në vend tëkëmishës. Njëri mes të pranishmëve i thotë: O i Dërguari i Zotit! A po ma dhuron mua atë triko? Po, sigurisht, - i përgjigjet Profeti. Vazhdoi edhe pak bisedën. Pastaj u kthye në dhomën e Tij. Palosi trikon. Më vonë ia dërgoi atij që ia kishte kërkuar. Ata që ndodheshin aty thanë: Sa me fat je! Profetit i duhej ajo triko. Pastaj ia kërkonte ti. Ti e di që ai nuk kthen mbrapsht dëshirën e dikujt. Dhe ai person u përgjigj kështu: Ju betohem për Zotin që unë nuk e mora për ta veshur. E mora ta kem qefin për vete. Sehl thotë që ajo triko u bë vërtet qefini i tij.⁴

Në një rast tjetër, kishte ardhur një nomad dhe kishte kërkuar diçka nga ai. Dhe Profeti ia kishte dhënë çfarë kishte dashur. Personi në fjalë kishte kërkuar përsëri diçka dhe ai ia kishte dhënë përsëri. Në kërkesën e tretë, Profeti, duke mos pasur ç't'i jepte, i kishte premtuar për më vonë. Pra, do t'ia jepte sapo të kishte diçka në dorë. Kjo gjë e kishte mërzitur pa masë Omerin dhe ishte mërzitur për shqetësimin e Profetit në mënyrë të tillë. U ngrit mbi gjunjë dhe tha: "Kërkuan, ti ia dhe. Përsëri kërkuan, përsëri ia dhe. Përsëri kërkuan, ia premtove. Mos e lodh veten kaq shumë, o i Dërguari i Zotit!"

Por këto fjalë nuk i kishin pëlqyer fare Profetit. Abdullah b. Hudhafetu Sehmi, pasi kishte parë ngrysjen e vetullave të tij, u ngrit në këmbë dhe tha: "Dhuro, o i Dërguari i Zotit, mos mendo asnjëherë së Zoti do të lërë të varfër dhe të ndërpresë mirësitë e Tij.

I vetmi i botëve, qëndroi pak i heshtur dhe pastaj foli: "Ja, unë për këtë jam urdhëruar."⁵

Brenda rrethit të së lejuarës ai i përgjigjej menjëherë dëshirës së një personi dhe i jepte çfarë të donte. Mbreti i Profetëve ishte i vetëm në bujari dhe më të nuk kishte të ngjashëm.

3 Buhari, 4/1866; Bezar, 1/303

4 Buhari, 1/429, 2/737; Ibn Maxhe, 2/1177; Ahmed b.

Hanbel, 5/333

5 Bezzar, 1/396

DOMETHËNIA E SADAKASË SË FITRIT



Fitr do të thotë krijim, natyrë, mbyllje e agjërimit, etj. Sadakaja ose lëmosha e fitrit quhet shkurt edhe fitre. Sadakaja e fitrit është një adhurim pasuror (material) që e kanë për detyrë ta zbatojnë myslimanët që zotërojnë pasurinë e quajtur nisab (përveç nevojave të përditshme) si dhe personat që kanë nën kujdestari, të cilët arrijnë bajramin e ramazanit.

Sadakaja e fitrit quhet ndryshe edhe "zekat për kokë". Ky emërtim nisët nga fakti që sadakaja e fitrit është një përgjegjësi e mbështetur mbi personat, mbi numrin e personave të familjes të përbërë nga kryefamiljari ose kujdestari dhe personat që ka nën kujdestari.

Sadakaja e fitrit është një adhurim që ka zënë vendin e vet në fe si një falënderim ndaj dhuntisë së jetës dhe trupit të favorizuar nga Allahu për personin dhe personat që ai ka nën kujdestari. Prandaj mbajtja e agjërimit nuk është kusht që sadakaja e fitrit të jetë ose të bëhet vaxhib. Edhe ata që s'mbajnë agjërime ose që s'munden të mbajnë agjërime, e kanë vaxhib të japin sadaka fitri.

Sadakaja e fitrit bart edhe kuptimin e falënderimit ndaj Allahut të Lartë që i bëri myslimanët, të cilët mundën ta plotësojnë atë vit adhurimin e agjërimit, të aftë për ta kryer këtë adhurim. Në të njëjtën kohë, siç bëhet e ditur në hadithin profetik, për myslimanin që ka mbajtur agjërime, sadakaja e fitrit plotëson mangësitë e adhurimit të tronditur me sjellje që s'i kanë hije personit të agjëruar. Gjithashtu, sadakaja e fitrit siguron pjesëmarrjen e të varfërve në gëzimin e bajramit. Veçanërisht, është thënë se dhënia e sadakasë së fitrit është shkak për pranimin e agjërimit, për shpëtim, për lehtësimin e vuajtjeve të çastit të vdekjes dhe të varrit.

Sadakaja e fitrit zbatohet nga personat përgjegjës në një kuadër shumë më të gjerë se zekati. Kështu, çdo njeri që ka mundësi për të dhënë sadakanë e fitrit, shijon kënaqësinë e dhënies së diçkaje në rrugën e Allahut, sheh dhe kupton më nga afër gjendjen e njerëzve nevojtarë në shoqëri. Nga ana tjetër, edhe njerëzve të varfër u zgjatet dora e ndihmës duke ua ruajtur nderin dhe duke mos i lënë të detyruar të kërkojnë. Kështu, mes individëve që jetojnë në të njëjtën shoqëri, ngrihet dhe funksionon edhe një urë tjetër vëllazërie dhe miqësie!

Dhënia e sadakasë së fitrit duke marrë si masë sasinë që do të siguronte ushqimin njëditor normal të një personi është kriteri më i saktë. Duke vepruar kështu, marrja si masë jo e nevojës ushqimore njëditore sipas standardit të jetesës së një të varfëri, por sipas mesatares së konsumit ditor të lëndëve ushqimore të personit që e jep sadakanë

e fitrit, është më në përshtatje me kuptimin dhe qëllimin e sadakasë së fitrit. Fakti që në Kuran, në lidhje me kefaretin e betimit, urdhërimi i formës "ushqyerja e dhjetë të varfërve me mesataren e ushqimit të dhënë familjes" (Maide, 5/89), e mbështet këtë qëndrim. Në mënyrë të veçantë, sasisht e përcaktuara në hadithe si masë të sadakasë së fitrit dhe të marra si masë në librat e fikhut (të drejtës islame), janë kufij minimalë.

Këshillat dhe porositë e Profetit në lidhje me këtë çështje, synojnë t'i shpëtojnë të varfrit nga lypja, të ushqehen ata e të marrin pjesë në gëzimin e bajramit. Personi që ka për të dhënë sadakanë e fitrit, duhet ta përcaktojë dhe ta japë atë në vlerë monetare të tillë që të mund të përmbushë të paktën nevojën ushqimore njëditore të një të varfëri, sipas gjendjes ekonomike dhe standardit jetësor të vetë personit.

Duke u nisur nga fakti që paraja vlen për plotësimin e çdo lloji nevojë, dhënia e sadakasë së fitrit në monedhë është më e mirë. Megjithatë, sipas nevojës, mund të jepet edhe me lëndët ushqimore të përmendura. Personi që jep sadakanë e fitrit, mund t'ia japë atë si një të varfëri të vetëm, ashtu dhe duke ua shpërndarë disa të varfërve. Por, për sa i përket përballimit të nevojave të personit të varfër, dhënia një të varfëri është më e mirë.

Ajete për bamirësinë
(Bekare: 262-265)

Ata që shpenzojnë pasuritë e tyre në rrugën e Zotit dhe nuk e përcjellin shpenzimin e bërë me të përmendura e mundim, e kanë shpërblimin pranë Zotit të tyre. Nuk frikësohen e dëshpërohen. (262)

Një fjalë e mirë dhe ndjesë, kanë më vlerë, nga një lëmoshë e përcjellë me mundim. Zoti është i pasur, i butë. (263)

Besimtarë, mos i zhvleftësoni lëmoshat tuaja me të përmendura e mundim si ata që shpenzojnë pasuritë e tyre për opinionin e njerëzve dhe nuk besojnë Zotin dhe Ditën e Fundit. Shembulli i tyre: një shkëmb i mbuluar me dhe; e zë shi i madh dhe e lë të zhveshur. Nuk zotërojnë gjë në fitimin e tyre. Zoti nuk i drejton njerëzit mohues. (264)

Shembulli i atyre që, të vendosur në vetvete, shpenzojnë pasuritë e tyre në kërkim të kënaqësisë së Zotit, një kopsht në vend të lartë: e zë shi i dendur dhe jep frytet e tij dy herë më shumë; në mos shi i dendur edhe një vesë. Zoti është largpamës i veprave tuaja. (265)

Shqipëruar nga Salih Ferhat Hoxha

Zemra

ËSHTË PESHORJA E BESIMIT

Ebu Hurejra r.a. transmeton se Profeti a.s. ka thënë: “Me të vërtetë, Allahu nuk shikon as trupat dhe as pamjen tuaj, por shikon zemrat dhe veprat tuaja”¹.

Shpjegimi i hadithit

Allahu i Lartësuar i ka dhënë njeriut mjaft mirësi e begati: shqiptimin, shikimin, dëgjimin, duart me të cilat njeriu e perfeksionon punën e tij, këmbët me të cilat ecën e shumë e shumë mirësi të tjera. Nuk ka dyshim se pesë shqisat dhe organet funksionojnë vetëm me vullnetin dhe dëshirën e Allahut të Lartësuar. Njeriu është përgjegjës për mirëfunksionimin e tyre. Pikërisht, për këtë përgjegjësi Allahu i Lartësuar na ka tërhequr vëmendjen, duke thënë në Kur’anin Fisnik: “Mos shko pas diçkaje për të cilën nuk ke dijeni. Vërtet, dëgjimi, shikimi dhe zemra, të gjitha këto do të merren

¹Muslimi, 2564.

në përgjegjësi.”²

Ky hadith dëshmon se mirësitë që Allahu i Lartësuar ua ka dhënë robve të Tij, i ndihmojnë ata për të plotësuar nevojat e tyre jetike, që ndryshojnë vazhdimisht. Mirëpo, këto e humbasin vlerën dhe funksionin e tyre të vërtetë, nëse zemra nuk luan rolin e peshores, që vendos balancën e drejtë në mirëfunksionim e tyre, në mënyrë që njeriu të jetë një adhures i përkushtuar ndaj Allahut të Lartësuar.

Këtë koncept kaq domethënës e gjejmë te fjala e Profetit a.s., i cili me pak fjalë shpreh shumë gjëra: “Me të vërtetë, Allahu nuk shikon as trupat dhe as pamjen tuaj, por shikon zemrat dhe veprat tuaja”.

Në Kur’anin Fisnik ka shumë ajete që flasin rreth këtij koncepti, që konsiderohet prej shenjave të personalitetit të myslimanit në raport me Krijuesin

² Isra, 36.

e tij. Allahu i Lartësuar thotë: "Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve rrëqethen kur përmendet Allahu dhe kur u lexohen shpalljet e Tij, u forcohet besimi dhe vetëm te Zoti i tyre mbështeten"³.

Zemra është ajo që bën dallimin mes punëve të mira ose veprave të këqija. Profeti a.s. e ka përcaktuar mjaft qartë rolin e saj, teksa thotë: "Me të vërtetë në trup ka një copë mishi, nëse ajo përmirësohet atëherë i gjithë trupi është mirë, por nëse ajo është e prishur, atëherë i gjithë trupi është i prishur. Kjo copë mishi është zemra"⁴.

Nuk ka dyshim se në Ditën e Kiametit, kujdesi hyjnor, mëshira dhe shpërblimi i Allahut të Lartësuar do të jetë për njerëz të tillë, ngaqë zemrat e tyre ishin të pastra e të dëlira.

Ky hadith përmban të njëjtin kuptim me ajetin kuranor: "O njerëz, në të vërtetë, Ne ju krijuam prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij"⁵.

Allahu i Lartësuar nuk shikon trupat e njerëzve, nëse janë të vegjël apo të mëdhenj, të shëndoshë apo të sëmurë, të bukur apo të shëmtuar. Të gjitha këto janë të papërfillshme tek Allahu i Lartësuar. Po ashtu, Ai nuk shikon se kujt fisi i përket, madje nuk shikon as pasurinë e njeriut. E vetmja gjë që i lidh krijesat me Krijuesin është devotshmëria. Ai njeri që e ka më shumë frikë Allahun e Lartësuar, është më pranë Tij dhe më i nderuari tek Ai. Prandaj njeriu nuk ka pse të krenohet me forcën fizike, me pasurinë, me fëmijët, me makinën e tij apo me gjëra të tjera të ngjashme. Nëse je i devotshëm, i përkushtuar dhe e ke frikë Allahun e Lartësuar, atëherë dije mirë se kjo është mirësi dhe begati nga Allahu i Lartësuar. Ajo që Allahu shikon është vetëm zemra e njeriut.

Zemra është boshti kryesor i punëve të njeriut. Sa e sa njerëz në dukje bëjnë vepra të mira, por në realitet ata kanë një zemër të rrënuar. Nijeti që del nga zemra, është baza e çdo veprë. Ndodh që dy persona të falen në të njëjtin rresht, por distanca ndërmjet tyre është si distanca ndërmjet lindjes dhe perëndimit, sepse zemrat e tyre janë krejt të ndryshme. Njërit i anon mendja dhe zemra nga të mirat materiale të kësaj bote, ndërsa tjetri e ka drejtuar mendjen dhe zemrën vetëm tek Allahu i Lartësuar. Vepra e njeriut vlerësohet në varësi të zemrës dhe po në varësi të saj ai do të shpërblehet në Ditën e Kiametit. Allahu thotë: "Me të vërtetë, Ai është i fuqishëm për ta kthyer atë në jetë, ditën kur do të zbulohen të fshehtat"⁶.

Nëse ajo që fshihet në zemër është e mirë, atëherë ky është përgëzim për njeriun, në të kundërt, e

ardhmja e njeriut do të jetë e zyrtë. Allahu i Lartësuar thotë: "Vallë, a nuk e di ai se kur të nxirren jashtë ata që gjenden në varre. Dhe, kur të dalë në shesh ajo që është në gjokse"⁷.

Duke qenë se Allahu i Lartësuar dhe Profeti a.s. na urdhërojnë dhe na porosisin që të përmirësojmë zemrën, atëherë është detyrë e njeriut që ta përmirësojë atë. Nëse njeriu ka dyshime në zemër rreth besimit, atëherë le ta largojë dyshimin e tij, duke parë krijesat e Allahut të Lartësuar. Allahu thotë: "Në krijimin e qiejve dhe të Tokës, në ndryshimin e natës dhe të ditës, ka argumente për ata që kanë logjikë"⁸.

Ky hadith profetik na fton të gjithëve, që të përpiqemi maksimalisht për përmirësimin e zemrave, sepse zemra është promotori i ndjenjave dhe i emocioneve. Këto ndjenja dhe emocione duhet të promovojnë vlerat njerëzore dhe parimet e larta të Islamit.

Zemra është shumë e ndjeshme, prandaj ajo goditet nga shumë sëmundje. Prandaj njeriu është urdhëruar që t'i bëjë ballë e t'i rezistojë të gjitha këtyre sëmundjeve të rrezikshme. Allahu i Lartësuar thotë: "Në atë ditë nuk do të vlejë pasuria e as fëmijët, përveç atij njeriu që vjen përpara Allahut me zemër të pastër"⁹.

Ka jo pak njerëz, të cilëve iu pëlqen vetja, sepse janë të pashëm apo të fortë fizikisht. Kjo bukuri trupore apo forcë fizike i bën ata që të jenë mendjemdhenj, arrogantë, madje ata i nënçmojnë dhe i përçmojnë të tjerët. Persona të tillë nuk arrijnë ta kuptojnë domethënien e këtij hadithi profetik. Ata nuk e dinë se ç'do të thotë që njeriu të përjashtohet nga kënaqësia dhe mëshira e Allahut të Lartësuar për shkak të një mendjelehtësie të tillë. Kjo kategori njerëzish klasifikohet në grupin e atyre të cilët e shitën jetën e tyre për hiçgjë. Allahu i Lartësuar thotë: "Vërtet, ata që premtimin e tyre dhe betimin e tyre ndaj Allahut e shkëmbejnë me një vlerë të vogël, nuk do të kenë asnjë të mirë në jetën e ardhshme. Allahu nuk do t'u flasë atyre, as nuk do t'i shikojë në Ditën e Gjykimit dhe as nuk do t'i pastrojë prej gjynaheve e për ta do të ketë dënim të dhembshëm"¹⁰.

Në një formë krejt të shkurtër e të thjeshtë, ky hadith profetik na tërheq vëmendjen që të ruhem nga sëmundjet, që infektojnë individin dhe shoqërinë. Nuk ka dyshim se fjalët e Profetit a.s. do t'i dëgjojnë vetëm ajo zemër, e cila është e lidhur ngushtë me Allahun e Lartësuar.

Për të pasur një jetë të qetë, njeriu duhet ta ketë zemrën e pastër, të flasë mirë dhe të sillet në mënyrë korrekte. Njeriu duhet të ketë një zemër të pastër, nëse dëshiron që këmbët e tij të ecin gjithmonë në

3 Enfal, 2.

4 Buhariu 2051, Muslimi 1599.

5 Huxhurat, 13.

6 Tarik, 7-8.

7 Adijat, 9-10.

8 Al Imran, 190.

9 Shuara, 88-89.

10 Al Imran, 77.

rrugën e Allahut të Lartësuar. Ai person, i cili nuk e ul shikimin ndaj haramit, nuk e ka problemin te sytë, por te zemra e sëmurë. Ai që nuk e ndalon gjuhën nga përgojimi dhe nga fjalët e pahijshme, nuk e ka problemin te gjuha, por te zemra e tij, e cila është e sëmurë, madje çdo ves i keq e ka burimin te zemra e sëmurë e njeriut. Me të drejtë Profeti a.s. lutej me këto fjalë: "O Zot, unë të lutem të më ruash nga një zemër që nuk përkushtohet". Pra, çdo gjë varet nga zemra.

Mësimet e nxjerra nga hadithi

- 1 - Rëndësia e zemrës së pastër.
- 2 - Rëndësia e punëve të mira.
- 3 - Maturia në vlerësimin e dikujt.
- 4 - Komunikimi i të vërtetës.

1 - Rëndësia e zemrës së pastër

Ky hadith flet qartë për rëndësinë e zemrës. Ai tregon se njeriu e bën të mirë zemra dhe jo pamja e tij e jashtme. Argument për këtë është ajeti kuranor: "O njerëz, në të vërtetë, Ne ju krijuam prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj dhe fise për ta njohur njëri-tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij"¹¹. Nëpërmjet këtij ajeti kuranor, Allahu i Lartësuar na njofton se origjina e të gjithë njerëzve është një. Të gjithë njerëzit janë pasardhës të Ademit a.s. dhe Havasë. Prej Ademit a.s. dhe Havasë kanë ardhur të gjithë njerëzit - duke u shtuar - derisa janë krijuar fiset dhe më pas popujt. Shkaku kryesor i kësaj ndarjeje (në fise e popuj) është që njerëzit të njihen dhe të ndërveprojnë mes tyre. Njeriu më i mirë dhe më i nderuar tek Allahu i Lartësuar është më i devotshmi. Tek Allahu i Lartësuar nuk është më i mirë ai që ka më shumë miq e të afërm, pozitë të lartë, emër, pasuri, etj. Zemra e njeriut është ajo nëpërmjet të cilës ai merr vlerësimin që i takon. Pamja e jashtme dhe paratë nuk kanë asnjë vlerë. Ajo që vlen të shikohet është zemra e pastër, e cila beson vetëm tek Allahu i Lartësuar dhe e shtyn njeriun që të bëjë vetëm punë të mira. Kur njeriu arrin këtë gradë, ka arritur pozitën e devotshmërisë, për të cilën flet edhe ky ajet kuranor.

Hadithi na nxit që t'i kushtojmë rëndësi gjendjes së zemrës, ta pastrojmë atë nga çdo ves i lig, si dhe ta pajisim me virtutet më të larta. Duke qenë se Allahu i Lartësuar shikon zemrën dhe jo trupin, atëherë është e domosdoshme, që njeriu herë pas here të kontrollojë e të mbikëqyrë zemrën e tij. Përmirësimi i zemrës ka më shumë përparësi sesa kujdesi ndaj trupit. Ibn Muflih thotë: "Përmirësimi i zemrës sjell përmirësimin e të gjithë trupit, ndërsa prishja e zemrës e prish të gjithë trupin". Dijetari i shquar Ibnul Kajim thotë: "Zemrat kanë dy emigrime: emigrimi për tek Allahu i Lartësuar, me nijet të pastër, dashuri, frikë, shpresë

e përkushtim; emigrimi për tek i Dërguari i Allahut a.s., nëpërmjet bindjes, përluljes dhe nënshtrimit ndaj gjykimit të tij. Nëse në zemrën e njeriut nuk ekzistojnë këto dy emigrime, atëherë njeriu le të hedhë hi mbi kokë, le t'i kthehet besimit, le të kthehet prapa për të përfutur nga drita hyjnore, përpara se t'i vulozet zemra, pasi një gjë e tillë i ndodh në urën e Siratit, pas murit¹². Në një vend tjetër, ai thotë: "Zemra e njeriut nuk pastrohet, nëse ai nuk shpëton nga pesë gjëra: nga idhujtaria që është kundër besimit në një Zot; nga bidati që e kundërshton traditën profetike, nga epshi që nuk ndjek urdhëresat, nga gafleti (shkujdesja) që të bën të harrosh Allahun e Lartësuar dhe nga syfaqësia që e prish punën e mirë"¹³.

Çdo mysliman e ka për detyrë që ta pastrojë zemrën e tij. Zemrat e njeriut pastrohet, duke lexuar Kur'anin, duke medituar dhe zbatuar porosinë e tij. Allahu i Lartësuar thotë: "Ata që besojnë dhe zemrat e të cilëve qetësohen, kur përmendet Allahu. Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut"¹⁴. "O besimtarë, bindjuni Allahut dhe të Dërguarit kur ju thërret drejt asaj që ju jep jetë dhe dijeni se Allahu ndërhyt midis njeriut dhe zemrës së tij dhe se tek Ai do të mbliidheni të gjithë"¹⁵.

2 - Rëndësia e punëve të mira

Kjo gjë vërehet te thënia e Profetit a.s.: "...në të vërtetë Ai shikon zemrat dhe punët tuaja". Kur'ani Fisnik ka folur shumë për vlerën e punëve të mira. Allahu i Lartësuar thotë: "Thuaj: Punoni, se Allahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët do ta shikojnë punën tuaj. Së shpejti do të ktheheni tek Ai, i Cili di të dukshmen dhe të padukshmen e Ai do t'ju njoftojë për atë që keni bërë"¹⁶. Puna e mirë është shkak i zëvendësimit të gjynaheve me sevape. Allahu i Lartësuar thotë: "Përfashtim bën ai që pendohet, beson dhe bën vepra të mira. Një njeriu të tillë Allahu ia ndërron veprat e këqija me të mira. Allahu është Falës e Mëshirëplotë"¹⁷. Puna e mirë është shkak për hyrjen në Xhenet. Allahu i Lartësuar thotë: "Padyshim, ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Allahu do t'i vendosë në Xhenete, nëpër të cilat rrjedhin lumenj"¹⁸. Allahu i Lartësuar e ngre lart punën e mirë. Ai thotë: "Kush dëshiron lavdi e pushtet, ta dijë se e gjithë lavdia dhe pushteti i takojnë Allahut. Tek Ai ngjiten fjalët e bukura, ndërsa veprën e mirë Ai e ngre Vetë"¹⁹. Në mënyrë që puna e mirë të jetë e pranueshme dhe myslimani të marrë

12 "Medarixhus Salikin" i Ibn Kajim el Xheuzije, f. 3/336.

13 Po aty, f. 3/337.

14 Ra'd, 28.

15 Enfal, 24.

16 Teube, 105.

17 Furkan, 70.

18 Muhamed, 12.

19 Fatir, 10.

11 Huxhurat, 13.

shpërblimin e saj, ajo nuk duhet të shoqërohet me syfaqësi. Ibn Kudame el Makdisi ka thënë: "Puna pa nijet është telash, nijeti pa sinqeritet është syfaqësi dhe sinqeriteti pa kënaqësi është pluhur". Allahu i Lartësuar thotë: "Ne do t'u qasemi veprave që kanë bërë dhe do t'i shndërrojmë në pluhur e hi"²⁰. Gjëja e parë që duhet të ketë parasysh çdo njeri - i cili synon të kryejë një punë të mirë - është nijeti i tij. Pasi ta ketë pastruar nijetin, ai kryen edhe punën e mirë. Këto dy elementë janë shkak, që njeriu të shpëtojë në botën tjetër"²¹.

3 - Maturia në vlerësimin e dikujt

Disa njerëz i kushtojnë rëndësi punëve të dukshme, por Allahu i Lartësuar e di mjaft mirë se çfarë fshehin ata në zemrat e tyre. Po ashtu ka edhe njerëz që neglizhojnë në adhurim apo kryejnë mëkate, por Allahu i Lartësuar e di se ata janë të pastër në zemër dhe mund t'i falë për këtë. Punët që njerëzit i veprojnë, nuk tregojnë në formë të prerë përkushtimin e tyre. Prandaj nuk kemi pse të flasim me lëvdata të mëdha për dikë, kur shikojmë se ai kryen shumë vepra të mira. Po ashtu, nuk kemi pse të nënçmojmë një mysliman, i cili kryen diçka të pahijshme. Është e vërtetë që duhet ta nënçmojmë sjelljen e pahijshme, por jo personin që e vepron atë. Kjo çështje është mjaft delikate, prandaj duhet pasur shumë kujdes në trajtimin e saj, veçanërisht kur dihet se zemrat janë në dorën e Allahut të Lartësuar.

4 - Komunikimi i së vërtetës

Në këtë hadith, Profeti a.s. na komunikon një të vërtetë: se Allahu i Lartësuar nuk shikon trupin dhe pamjen e njeriut, por shikon zemrën dhe veprat e tij. Është detyrë themelore e ftuesit, që t'u tregojë të tjerëve të vërtetën në lidhje me çështjet e fesë, madje Allahu i Lartësuar e ka urdhëruar Profetin a.s. me një gjë të tillë: "O i Dërguar, komunikojë atë që të është shpallur nga Zoti, se nëse ti nuk e bën, atëherë nuk e ke komunikuar shpalljen"²². "Ty, o Muhamed, të zbritëm përkujtimin, që t'i sqarosh njerëzit për atë që i është zbritur. Ndoshta ata do të logjikojnë"²³. Në momentin kur ftuesi ia komunikon të vërtetën njerëzve, atëherë kjo e vërtetë është dëshmi dhe përgjegjësi për secilin prej tyre. Imam Es Sa'di thotë: "Allahu i Lartësuar e urdhëroi Profetin a.s. me një prej urdhëresave më të rëndësishme, që është komunikimi i mesazhit hyjnor. Ky komunikim përmban çështjet e besimit, rregullat dhe dispozitat fetare, fjalët, veprat dhe urdhëresat hyjnore. Profeti a.s. e zbatoi këtë urdhër hyjnor me

përpikëri, me fjalë, me vepra dhe me sjellje, madje këtë e ka shprehur edhe nëpërmjet letrave, që ua dërgonte mbretërve të vendeve të ndryshme. Ai a.s. ia ka komunikuar popullit të tij çdo të mirë, ashtu siç i ka paralajmëruar edhe për çdo gjë të keqe. Pra Profeti a.s. e komunikoi mesazhin hyjnor te njerëzit. Këtë e kanë dëshmuar njerëzit më të mirë: sahabët, tabiinët, dijetarët e fesë dhe të gjithë njerëzit e sinqertë"²⁴.

Argumentet dhe dobietë e hadithit

- 1 - Vlera e madhe që ka zemra.
- 2 - Domosdoshmëria e pastrimit të zemrës.
- 3 - Lidhja e ngushtë mes zemrës dhe punëve të mira.
- 4 - Zemra e mirë korrigjon veprat e njeriut.
- 5 - Përmirësimi i zemrës ka më shumë përparësi sesa pamja e jashtme e njeriut.
- 6 - Pamja e jashtme nuk merret për bazë në vlerësimin e punëve tek Allahu i Lartësuar.
- 7 - Njeriu duhet të largohet nga shenjat e injorantëve, të cilët mburren me pamjen e tyre të jashtme.
- 8 - Allahu i Lartësuar shikon zemrën dhe punën e njeriut e jo pamjen dhe trupin e tij.
- 9 - Motivimi për të pasur nijet të sinqertë.
- 10 - Njeriu shpërblehet në varësi të nijetit të tij.
- 11 - Njeriu është përgjegjës për nijetin dhe punën e tij, prandaj duhet të jetë gjithmonë i kujdesshëm.
- 12 - Motivimi i njeriut për të ndërë mbikëqyrjen e Allahut të Lartësuar.

Epilog

Në kohën e Profetit a.s. ka jetuar një sahabi. Ai ishte i varfër dhe i shëmtuar. Një ditë Profeti a.s. e pyeti se përse nuk ishte martuar. Ai i tregoi arsyen e vërtetë: "E kush martohet me mua, që jam kaq i shëmtuar?!" Profeti a.s. i tha: "Shko te filan shtëpi dhe kërko dorën e vajzës së tyre". Personi në fjalë vajti dhe u tha prindërve të vajzës, se Profeti a.s. e kishte dërguar që të kërkonte dorën e saj. Ata e refuzuan, pasi ai ishte i shëmtuar, mirëpo vajza - e cila i kishte dëgjuar - u tha prindërve: "Si mund ta thyeni fjalën e Profetit a.s.?" Kjo vajzë besimtare u martua me këtë sahabi, për t'iu bindur urdhrit të Profetit a.s. Menjëherë pas martesës, në rrugët e Medines dëgjohet thirrja për luftë. Ky sahab i nderuar - ashtu si edhe sahabët e tjerë - nuk ngurroi që t'i përgjigjet thirrjes. Ai mori pjesë në luftë dhe ra dëshmor.

Vërtet ai ishte i shëmtuar në sytë e njerëzve, por tek Allahu i Lartësuar gëzonte një pozitë të lartë dhe fitoi gradën më të lartë - gradë që e dëshiron çdo besimtar - të dëshmorit në rrugën e Allahut të Lartësuar.

Ky sahab i nderuar quhej Xhulejbib, Allahu qoftë i kënaqur me të.

Allahu na bëftë të gjithëve prej banorëve të Xhenetit.

20 Furkan, 23.

21 "Muhtesar Minhaxhul Kasidin" i Ibn Kudame Makdisi, f. 393.

22 Maide, 67

23 Nahl, 44.

24 "Tefsir i Sa'dit", f. 201.

ROLI I HYGJENËS në fenë Islame



Po t'i hidhnim një sy vëzhgimtar dispozitive Kuranore si dhe fjalëve Profetike, kemi me konstatue në çast, se një ajo shkencë e cila në të gjithë botën hypi në nivelin ma të naltë, në pikëpamje të rufjes së shëndetit, asht thanë dhe predikue po me të njëjtat si sot. Po t'a marrim çështjen në shqyrtim për çka ka thanë e ba Islami për mi këtë shkencë, do të mundemi me qit në dritë me fare pak mundim se, i ka kushtue asaj vendin e nderit në lamshin e problemave të tjerë qi ndesheshin për t'u zbërthye.

Të gjitha nj'ato urdhëna dhe kondita shëndetësore të vueme si baza të një edukate fetare në Islamin, janë ata të cilët praktikisht na japin rezultatin për me mund me gëzue një shëndet të plotë, në mënyrë qi po të kemi freskin e shëndetit, do të jemi shum ma në gjendje me përmbush udhëzimet morale, të cilat na naltësojnë shpirtnisht. Për një njeri të pashëndetshëm dhe të prekun prej sëmundjesh, do të ishte një gja e pamundur qi të futet thellë në fushën e përmbushjes të sa e sa detyrimeve qi i ngarkohen si individ; tue pas gjithashtu hallin e dhimbjeve dhe të këputjes shëndetësore, nuk do të jetë në gjendje t'i kushtojë ndonji pikë djerse dhe mudi kolektivitetit; nuk do të mundet të studiojë dhe të dij diçka në lamshin e nyjeve qi paraqiten në vëllimin infinit; nuk do të mundet për me e përmbush si duhet përjetësimin e tipit të tij – urdhën i natyrshëm i të gjithë individëve pa dallim – për arsye se pashëndetsija asht gardhi ma i tmerrshëm qi na ndalon për të nga vrik në problemin demografik, problem i cili asht vue në rradhët e para të të gjithë shoqive të botës.

Të gjitha këto janë parapa dhe studjue imtas në Islamin, tue na u tregue dhe na fol kjasht me gojën e një vargu konditash shëndetësore, thanë dhe predikue që në fillim të Islamit. Shkenca e hygjenes në Islam shihet kjasht se ka pas vendin e nderit, gja qi vazhdon ta ketë edhe sot e kësaj dite, ngaqi nuk mundet të mos çaloj një besimtar për të gjatë udhës së besimit për në qoftë se nuk e pranon dhe nuk e din moton "Pastërtija asht një pjesë e besimit" ose "Pastërtija vjen nga besimi!" Një moto e cila në të vërtetë të ban me jetue çaste admirimi, sidomos kur shifen dhe dihen se u thanë dhe u predikuen nga një duzinë shekujsh përpara. Nuk mundet dhe as qi ka arsye të stërhollohemi në gjurmime faktesh të tjera, kur në krye të një këshille dhe dëshire për hygjën, shkëlqen një moto madhështore si kjo! Kjo asht ma e para arsye e cila na ban me konstatue pa diskutime se, Islami i ka dhanë rolin kryesor hygjenes dhe shëndetit. Nuk ka mundësi thanjesh të kundërta, gjithë ashtu ai qi merr mundimin për me i hye në zemër të studimit se çka tha e bani Islami për hygjën, do të shofi se, në kryesinë e vargut të njëjtit programi urdhënash për besimtarët, ka me gjet të lamunit e trupit (gyslin) si një nga konditat dhe urdhënat e domosdoshme për çdo njeri qi pranon me ndjek këtë rrugë. Në Islam, ashtu si nuk ka dhe nuk ka pas asnjihërë ndonji nen dhe urdhën absurd, nuk ka dhe nuk ka pas asnjihërë urdhëna dhe kondita të cilat nuk kanë të bëjnë me përmirsimin e jetës fizike dhe shpirtnore të individëve.

Me këtë artikull e kemi fjalën ke rrolli higjenik në fen Islame, e sikur t'i numroshim varg nj'ato urdhëna dhe fjalë Profetike të cilat iu kan kushtu kësaj shkence, do të na u dojshin disa duzina fletësh të kësaj riviste; me këtë rasë qëllimi asht me e thanë me pak fjalë se, në Islam shkenca e hygjenes ka pas dhe ka vendin e nderit, urdhënue prej Kryetarit të tij, në mënyrë qi asnjë

neglizhencë predikuesash ose interpretimi të keq, nuk mundet t'ia parrisi shkëlqimin. Do të ishte një faj i randë sikur ndonji mos respektim i urdhëve hygieniko-fetare t'i varet fesë, asht një faj i tjetërkuj për në qoftë se ndonji predikues i përcipët nuk e ka djtë mirë se, Profeti ka urdhënue për çdo njanin me hangar në çanakun (pjetën) e tij, dhe për në qoftë se atij predikuesi i duhen ndonji varg i gjatë dispozitash, le t'i mjaftojë vetëm ajo kur Profeti në një zifafet (gosti) qi u ftue një natë së bashku me gjithë shokët e tij, urdhënojë qi buka të hahet në çanakë dhe jo me një enë që të gjithë, për arsye se në atë familje paska pas një të sëmundë me lebër, gja qi len me u shikue fare mirë se, udhëheqësi i Islamizmës e ka pas shumë për shpirt hygjën, aq për shpirt sa qi po të mundemi me i pas parasysh gjithë atë mori urdhënash dhe këshillash qi jep për shëndetin dhe ruajtjen e tij, do të na duket vetja se po kalojmë çaste pranë ndonjë enti hygjentësh me famë botrore, tue qenë prezent në ndigjesë të ndonji fjalimi me randësi të kryetarit të tyne. Që të gjitha urdhëna të freskëta dhe të dobishme: Lani shtatin sa më shpesh, lani dhëmbët, pritni thonjt, mos hani në një çanak, mos e pini ujin pa e pa, ruhuni prej mizash dhe të tjera, janë që të gjitha po njato urdhëna hygienike me randësi të cilat ndijohen dhe sot e kësaj dite nga hygjentët ma të madhë të botës. Kjo mënyrë urdhënese asht kaq me randësi në Islam saqë po t'i stërhollojsh mirë e mirë do të dali si rezultat automatikisht se, "po nuk qe i pastër nuk mundesh për me qenë besimtar i mirë!" Në këtë mënyrë asht predikue në Islam problema e hygjenes deri në atë kohë kur njerëzit nuk dijshin as nuk kishin ndigjue ndonji herë për mbi randësin e saj, dhe po në këtë mënyrë u prue në udhën e drejtë populli arab i cili kishte mbërrë në një shpartallim moral dhe material përpara se të shfaqej Islami.

Kushdo qi pa marrë mundimin me bubrue dhe shfletësue në vëllimet e librave, ose pa u interesua të dij ma gjatë mbi dispozitat hygieniko-fetare të Islamit, nxiton rrëmbimthi për me dalë në skenën e fjalës, për ta hudh dasht e pa dasht si të bjeri në kryet e kësaj rruge, atij i themi me rrymën e së vërtetës dhe me vullën e pashlyere të nj'atij përparimi qi u vërsul në botë me Islamin se, janë tmersisht të gabuam, e për në qoftë se tue gjet rasë nga goja e ndonji predikuesi dhe udhërrëfyti inkompetent i jepet shkak me hap gojën kundra, prap për hirin e një të drejte të kjasht si drita e Diellit i lusim me vëzhgue ma imtas punën, për të mund me mbërrë n'atë pikë e cila të mahnit dhe të len me gojë hapun!

Siç thamë, çdo predikues i përcipt nuk ka dashtë të lodhet me gjurmimet e sakta të kësaj shkence në Islamin, ose qi për ndonji farsoj interesi personal ka guxue të heshti mbi këtë temë, tue marrë njihërit përsipër grumbullin e mallkimeve lëshue shpirtnisht nga një shoqni e madhe, nuk do të mundet kurr qi ta zaje sadopak këtë Diell të shdritshëm urdhënash dhe këshillash dobiprurëse; nuk do të mundet kurrë qi ndonjë predikues inkompetent i vendosun kushdi kur në katedrën e predikimit, i pazoti ose për qëllime të njanit dhe të tjetrit, tue qenë i paralizuem dhe në gjykim, ta shëmtojë këtë varg të madh interesimi qi ndehet ngadhënjimtarë prej mesit të Islamit për të depërtue deri në sferat ma të largëta të tij.



Mytesim Këllici

Myfti, Kadi në Kavajë, Durrës e Tiranë

Mytesim Këllici lindi në Tiranë në vitin 1866 në një familje patriotësh. I ati, Zyberi, që ishte hoxhë, duke qenë më i madhi i tre vëllezërve, e çoi për studime në Stamboll, ku kreu shkollën e mesme (medrese) dhe atë të lartën në teologji dhe drejtësi, që i kreu me rezultate të larta. Gjatë studimeve arriti të përvetësojë mirë gjuhët osmane, arabe dhe perse. Për një kohë qëndroi në Turqi edhe pas përfundimit të studimeve, ku caktohet pedagog në medresenë e lartë të Bursës dhe në atë të Izmirit. Për punë të mirë dekorohet dhe lavdërohet edhe nga Shejhul Islami.

Gjatë qëndrimit atje lidhet me atdhetarë, që luftonin për çështjen kombëtare si Dr. Ibrahim Temo

dhe Mihal Grameno.

Pasi kthehet në Shqipëri, fillimisht emërohet si myfti-kadi në Kavajë dhe më vonë transferohet në Durrës me të njëjtën detyrë. Për punë të mirë lavdërohet sidomos në lidhje me mbarëvajtjen e shkollave dhe të veprimtarive me karakter kombëtar.

Më 1908, në krye të një grupi atdhetarësh durrsak si Stefan Kaçulini, Kasëm Durrësi, Agostin Serreqi, etj. kërkojnë përdorimin e gjuhës shqipe. Mbas një viti, më 1909, merr pjesë në Kongresin e Dibrës me krahuin e grupit atdhetar, që kërkon hapjen e shkollave shqipe dhe përdorimin e alfabetit latin për shkrimin e gjuhës shqipe. Gjithashtu shprehet për

shërbesë fetare shqip ndër xhamia.

Në korrik e gusht të vitit 1912, kur ishte myfti në Durrës, në krye të një grupi atdhetarësh si Abaz Çelkupa, Jahja Ballhysa, Adem Karantina, Musta Ali Brahimi etj., mbledhin ndihma në popullin durrsak dhe shkon në Krujë për në Sarisalltik, ku takohet dhe i dorëzon ndihmat Abdi Toptanit, komandant i forcave kryengritëse. Prej andej shkon me grupin e përfaqësuesve të Shqipërisë së Mesme e të Veriut në Shkup me ftesë të Hasan Prishtinës, për miratimin e memorandumit prej 14 pikash paraqitur komisionit osman për të drejtat kombëtare. Merr pjesë në ngritjen e flamurit në Tiranë e Kavajë. Këtu i paraqitet rasti të miqësohet edhe me Isa Boletinin.

Rëndësi të veçantë Mytesimi i kushtonte bashkimit kombëtar pa dallim feje. Për këtë flet fakti se ai merr pjesë në përrurimin e kishës së re orthodokse në Durrës.

Gjatë Luftës së Parë Botërore internohet në Berat, ku qëndroi rreth 15 muaj, së bashku me Myslym Llagamin.

Kur atdheut i kërcënohej pavarësia, populli i Tiranës e zgjedh përfaqësues bashkë me Abdi Toptanin për në Kongresin e Lushnjës. Me gjithë presionin e bërë nga qeveria e Durrësit dhe komandanti italian në Durrës, ai shkon në Lushnjë dhe mbështet kongresin.

Në mbledhjen e këshillit Kombëtar më 27.3.1920, zgjidhet përkohësisht kryetar i senatit si më i moshuari i senatorëve që ishte.

Në prill 1920 nënshkruan bashkë me atdhetarët Ismail efendi Ndroqin, Abdi Toptanin, Muhedin Llagamin, Abdullah Alimehmetin etj., protestën që populli i Tiranës i dërgoi konferencës së paqes në San Remo për të mos cenuar pavarësinë dhe tërësinë tokësore të Shqipërisë.

Ai ndikoi gjithashtu në shkollimin e femrës tiranase si dhe në krijimin e strehës vorfënore për jetimët.

Duke qenë se aderonte në politikën e Nolit që në Kongresin e Lushnjës, Zogu më 1922 e internon në Gjirokastër ku qëndron për 14 muaj derisa u sëmur.

Vdiq në Tiranë më 28 shkurt 1924.

Me këtë rast, Hafiz Ibrahim Dalliu jep këtë njoftim në gazetën «Dajti»:

“Pardje i mbarojë nefert e kësaj jete e u varros myftiu i Tiranës Mytesim Këlliçi... shumë kohë myfti në Kavajë e në Durrës, një nga senatorët e Lushnjës, i vuajtur për çështjen kombëtare...”

Për të nderuar kujtimin e tij, qeveria e Nolit (1924), i vuri emrin një rrugë në lagjen ku banonte, emër që e mban edhe sot¹.



¹ Dizdari, Nasuf T., gazeta “Drita Islame”, nr. 8, 1992: 3.

FËMIJËT DHE TEKNOLOGJIA

Ditëve të sotme diskutojmë dhe mendojmë rreth efektit të botës digjitale dhe përdorimit të drejtë të teknologjisë tek njerëzimi. Bashkë me ndikimin negativ të periudhës pandemike pasojat e padëshiruara të përdorimit jo të duhur të teknologjisë kanë filluar të zënë një vend të konsiderueshëm në jetën tonë të përditshme. Më të prekurit nga kjo situatë janë fëmijët të cilët janë të paaftë dhe nuk arrijnë akoma të ndajnë të drejtën nga e gabuara .

Kjo platformë digjitale e pakontrolluar dhe e papërshtatshme arrin t'i tërheqë drejt vetes me metodat e tyre bindëse. Keta platforma po ecin me hapa galopantë në fushën e krijimit të një modeli të ri për fëmijët tane dhe kane si qëllim pastrimin e mendjeve të tyre të pastra . Pamjet dhe jeta perfekte e pasqyruar me anë të këtyre mjeteve nuk ka aspak lidhje me jetën reale . Ky fakt dëmton rëndë vetëbesimin dhe përshtatshmërinë sociale të fëmijës duke i hapur

rrugë shumë problemeve psikosociale. Bota digjitale po reklamon fitimin pa pasur nevojë të punosh apo të lodhesh dhe duke lënë pas dore socializimin e njeriut po e shtynë atë edhe më shumë drejt vetmisë. Në një kohë kur është rritur shumë përdorimi i mjeteve të tilla të cilat shkaktojnë vetëm pasoja negative fëmijët tanë nuk po arrijnë të mësojnë jetën nga eksperiencat reale por nga një botë fallco dhe artificiale .

Të gjitha studimet e realizuara deri tani flasin për ndikimin negativ të mjeteve teknologjike në zhvillimin gjuhësor, mendor dhe fizik të fëmijëve të cilët kalojnë një kohë të gjatë para tyre. Kur e analizojmë edhe më mire këtë studim shohim se pasojat negative në të folur e komunikim janë të lidhura direkt me përdorimin pa kriter të botës digjitale. Mjeket pediatër nuk rekomandojnë njohjen e fëmijës me tv para moshës 2 vjeçare. Në ambjentin digjital nuk ekziston ndërveprimi dhe komunikimi , bëhet fjalë vetëm për një transmetim



të njëanshëm. Ndërkohë që fëmijët mësojnë më mirë me dialog dhe jo me monolog . Faktorët që nxisin më shumë zhvillimin gjuhësor te fëmijët janë aftësitë imituese dhe domosdoshmëria e përdorimit të gjuhës. Një zhvillim i tillë nuk është i mundur në botën digjitale. Autorja Dana Suskind në librin e saj '30 milion fjalë ' e përshkruan trurin si një krijesë sociale. Mbajtja larg e tij nga komunikimi kufizon aftësitë e tij të të mësuarit dhe memorizimit të gjërave të mësuara. Trurin e njeriut mund ta krahasojmë me një gotë e cila pranon ujën që i hidhet brenda por nëse nuk ekziston ndërveprimi njerëzor ajo shndërrohet në diçka të pavlefshme. Studimet e fundit kanë treguar vështirësitë që shfaqen në përqendrim tek fëmijët të cilët ekspozohen për një kohë të gjatë para ekranit. Atmosfera digjitale përmban një numër të lartë stimuluesish dhe nëse truri i ekspozohet në mënyrë të vazhdueshme ndaj këtyre stimuluesve do të ulë performancën në fusha dhe

aktivitetet të tjera sic janë shkolla, librat , detyrat etj. Si rrjedhojë përjetohen probleme si humbja e përqendrimit dhe e vullnetit për të mësuar .

Çfarë mund të bëjmë përballë ndikimit të botës digjitale ? Pike së pari duhet të dime se fëmijët mësojnë duke marrë për bazë një model të caktuar. Nëse ankohe mi që fëmijët tanë kalojnë një kohë të gjatë para telefonëve apo tv atherë duhet të rishikojmë qëndrimin tone ndaj këtyre pajisjeve . Sipas një studimi të fundit vartësia e fëmijëve ndaj telefonit apo tv lidhej ngushtë me vartësinë e prindërve. Këta studime na hapin sytë për të rishikuar veten dhe për të bërë përmirësimet e duhura. Nëse para moshës dy vjeçare nuk këshillohet fare qëndrimi para ekranit apo telefonit pas moshës dy vjeçare këshillohet qëndrimi për një kohë shumë të shkurtër sipas moshës përkatëse.

RETINA

NJË MREKULLI E KRIJIMIT

Syri është një mrekulli më vete ashtu siç është krijuar. Megjithëse sot kemi një kuptim të përafërt të anatomisë së tij themelore, ne ballafaqohemi me një mrekulli shumë më komplekse kur hyjmë në proceset e ndërlikuara të anatomisë së tij dhe në fiziologjinë e aktit të shikimit. Ka shumë teori për të tilla procese si perceptimi i imazheve mendore dhe ruajtja e tyre në kujtesë, por ne ende nuk e dimë saktësisht se si realizohet shikimi.

Një nga shtresat më misterioze të syrit, retina, ka një strukturë të pajisur me një sërë funksionesh. Jo çdo kirurg oftalmolog guxon të prekë retinë, e cila strehon shtresat qelizore më të ndjeshme dhe të veçanta. Kjo është një strukturë tredimensionale në formë gjysmëhënëze e vendosur në pjesën e prapme të syrit dhe përbëhet nga dhjetë shtresa super të holla të qelizave që mbulojnë pjesën e brendshme

të syrit.

Shtresat e retinës

Dhjetë shtresat që formojnë retinë janë:

1. Shtresa e Pigmentuar (ngjyrosur)
2. Shtresa e shufrave dhe koneve
3. Membrana kufizuese e jashtme
4. Shtresa bërthamore e jashtme
5. Shtresa plexiforme e jashtme
6. Shtresa bërthamore e brendshme
7. Shtresa plexiforme e brendshme
8. Shtresa e Ganglioneve
9. Shtresa e fibrave nervore
10. Membrana kufizuese e brendshme

Dritë për shikim

Drita arrin dhe depërton nëpërmjet korneas, shtresa transparente në pjesën e përparme më të jashtme të syrit. Pastaj shkon përmes lëngut frontal (lëngu



ujor) dhe hapësirës që quhet pupila (bebja e syrit). Ajo godet murin e brendshëm të retinës pas kalimit nëpër lentin e syrit dhe më pas me lëngun qelqor që e mbush syrin në pjesën e prapme. Vetëm ky është një fakt interesant, sepse drita shkon shumë më vonë në shtresën e koneve dhe qelizave shufra të retinës, të cilat e perceptojnë dritën. Meqë këto qeliza konike dhe shufra janë të rreshtuara njëra pas tjetrës për mbrojtjen e tyre, drita arrin këtë shtresë të jashtme të retinës pasi ka kaluar qelizat e ganglioneve, shtresave të retinës dhe shtresave bërthamore. Një shtrirje e tillë çon në një reduktim të shikimit të mprehtë në rajonet periferike të retinës.

Fovea centrale

Shtresat e brendshme në qendër të retinës, në anën tjetër, janë të tërhequra anash për të parandaluar ndonjë humbje në mprehtësinë pamore. Ngjashëm

me një gropë, kjo pjesë është shumë më e hollë se periferia e retinës, kështu që shtresat që kanë gjasa të pengojnë kalimin e dritës dhe kështu të reduktojnë mprehtësinë vizuale, janë të radhitura në mënyrë specifike për të lejuar që drita të godasë drejtpërdrejt qelizat e koneve dhe shufrave. Përveç kësaj, qelizat konike, të cilat janë përgjegjëse për shikimin e mprehtë dhe me ngjyra, ekzistojnë në këtë rajon me shumicë, ndërsa qelizat e shufrave, të cilat janë përgjegjëse për pamjen periferike dhe pa ngjyra (të zezë dhe të bardhë), nuk gjenden aty. Fovea centrale ku mprehtësia vizuale është në nivelin më të lartë përgjigjet për shikimin e mprehtë, me ngjyra dhe të saktë. Pse atëherë pjesa tjetër e retinës nuk është krijuar për shikim të mprehtë dhe përse ky seksion i vogël është i pajisur me këtë aftësi?

Siç rezulton, në qoftë se tërë retina do të kishte

aftësinë për të parë me mprehtësi maksimale, atëherë nuk do të ishte e mundur që syri të përqendrohej në një vend dhe ta dallonte atë me saktësi nga objektet përreth. Nëse do mund të shihnim të gjithë faqen e një libri në një shikim, rreshtat do të ngatërroheshin në trurin tonë. Ne nuk do të ishim në gjendje të kuptonim atë që po lexonim. Normalisht ne fillojmë të lexojmë nga fillimi i faqes dhe vazhdojmë rresht pas rreshti, ndërsa përqendrohemi në çdo fjalë. Truri ynë pastaj mund të përqendrohet dhe të perceptojë një fjalë të vetme me saktësi duke kufizuar perceptimin e mprehtë të zonës përreth.

Shtresa e pigmentuar e retinës

Ngjyra e zezë është e njohur për thithjen dhe jo reflektimin e dritës. Në sajë të kësaj vetie të tillë, shtresa e përbërë nga pigmenti i zi (melaninës) ose ngjyra, ndalon reflektimin e dritës, e cila është thelbësore për mprehtësinë vizuale. Kjo substancë e zezë funksionon si ngjyra e zezë në dhomën e errët të kamerave të vjetra. Nëse nuk do të kishte asnjë shtresë për të absorbuar dritën, drita do të shpërndahej në murin brenda syrit, duke turbulluar kështu mprehtësinë midis dritës dhe ngjyrave të errëta, që është esenciale për formimin e një imazhi të qartë dhe duke prodhuar një imazh të paqartë për shkak të ndriçimit të përgjithshëm të retinës.

Njerëzit të cilëve u mungon ky pigment i melaninës, si pasojë e një defekti gjenetik (çrregullimi i Albinizmit), kanë flokë të bardhë dhe janë tepër të ndjeshëm ndaj dritës, sepse shtresa me ngjyrë e syrit nuk përmban pigmentin melaninë, i cili refrakton dritën. Kur një person albino hyn në një zonë të ndriçuar, drita që godet retinën reflektohet në të gjitha drejtimet përmes retinës së cilës i mungon pigmenti dhe sipërfaqeve të bardha të shtresës së ngurtë (sklera). Prandaj, një rreze drite që normalisht do të stimulonte disa kone ose shufra, shpërndahej kudo, duke stimuluar të gjithë ose shumicën e receptorëve të dritës. Si rezultat, mprehtësia vizuale në albinot mund të jetë vetëm midis 20/100 dhe 20/200, madje edhe me ndihmën e korigjimit më të mirë optik, e cila është një vlerë e ulët në krahasim me 20/20 në shikimin normal. Shakaja e njohur se lepujt nuk mbajnë syze sepse hanë karrota është e bazuar në përqendrimin e lartë të

vitaminës A në këtë pigment, ose ngjyrës së zezë. Në të vërtetë, vitamina A është një faktor vendimtar për cilësinë e këtij pigmenti.

Shtresa e shufrave dhe koneve

Përbëhet nga 127 milion qeliza receptore të ndjeshme ndaj dritës (fotoreceptorët), retina është 0.2 mm e trashë në vendin e verdhë (macula lutea), ku imazhi formohet më qartë dhe 0.1 mm të trashë në skajet e kësaj zone. 120 milion shufra cilindrike në retinë janë të ngarkuara me pamjen bardhë e zi (në muzg), dhe 7 milion kone, për shikimin me ngjyra dhe pamjen e mprehtë. Shufrat e cilat janë më të shumta, janë 50 µm (mikronë) në gjatësi dhe 1-5 µm në trashësi. Konet më pak të shpeshta janë 40 µm (mikronë) në gjatësi dhe 3-5 µm në trashësi.

Përqendrimi i koneve rritet drejt qendrës së retinës dhe zvogëlohet drejt skajeve, ku tejkalohet nga shufrat. Në citoplazmën e koneve dhe shufrave gjenden substanca që janë të ndjeshme ndaj dritës (fotosensitive) që shpërbëhen kur drita i prek ato duke prodhuar energji elektrike në membranën e tyre qelizore. Në shufrat, kjo substancë kimike quhet rhodopsin. Në konet, nga ana tjetër, janë tre substanca që korrespondojnë me ngjyrat e kuqe, jeshile dhe blu që janë të ndjeshme ndaj gjatësisë së valëve të dritës me ngjyrë. Për të qenë më të saktë, ekzistojnë tre qeliza konike të veçanta që përfshijnë një nga këto tre substanca. Kimikisht, substancat fotosensitive në kone janë pak më ndryshe nga rhodopsina.

Shkatërrimi i rhodopsinës me energji të lehtë

Rhodopsina, së bashku me substancat e tjera, mbushin rreth 40% të shkopinjeve dhe koneve. Ato janë të përbëra nga një proteinë e quajtur scotopsin dhe një molekulë të quajtur retininë që rrjedh nga vitamina A. Kur energjia e dritës absorbohet nga rhodopsina ose substancat me ngjyra, rhodopsina fillon të zbehet më shpejt se një trilion të sekondës. Arsyeja kryesore për këtë është që elektronet në retinën (vitaminë A) një pjesë e rodopsinës aktivizohet nga drita, gjë që ndryshon formën e molekulës së retinës me një shpejtësi të madhe (një trilionë të sekondës). Ndryshime tepër të komplikuar dhe të sakta kimike dhe fizike vijnë më pas. Është shumë e vështirë të monitorohen të

gjitha këto ndryshime biokimike dhe ato kërkojnë mjete shumë të specializuara.

Rigjenerimi i rhodopsinës së shkatërruar nga drita

Rhodopsina e shkatërruar nga drita rigjenerohet në errësirë. Vetëm në shekullin XX, ne arritëm të identifikojmë pjesërisht mekanizmin me anë të të cilit molekulat me forma gjeometrike shumë specifike prishen me shpejtësi të pabesueshme vetëm për t'u rigjeneruar më vonë. Është e mrekullueshme që një njohuri dhe fuqi e tillë është e pranishme në qelizë duke lejuar që energjia e dritës të shkatërrojë molekulën dhe të nisë po vetë procesin e rigjenerimit. Qarkullimi vicioz midis shkatërrimit dhe rigjenerimit të kësaj molekule vazhdon gjatë gjithë jetës. Vitaminës A i është caktuar një detyrë vendimtare në rigjenerimin e rhodopsinës në errësirë. Retinali i formës trans konvertohet në retinë në retinolin trans, i cili pastaj konvertohet në retinol 11-cys me ndihmën e një enzimi isomerazë. Së fundi, 11-cys retinoli konvertohet në retinë 11-cys, e cila nga ana e saj kombinohet me scotopsinën për të formuar rhodopsinën. Vitamina A është e pranishme si në citoplazmën e shufrave dhe në shtresën e pigmentit të retinës. Në këtë mënyrë, vitamina A mbahet në rezervë për t'u përdorur për gjeneratat e retinës së re. Nëse, nga ana tjetër, ka një tejkalim të vitaminës A në retinë, pjesa e tepërt konvertohet në retinë, me të cilën ulet sasia e pigmentit të ndjeshëm ndaj dritës në retinë.

Verbëria e natës

Verbëria e natës shfaqet në ato persona që vuajnë nga mungesa serioze e vitaminës A. Për shkak se mungon vitamina A që duhet konvertuar në retinë, sasia e rhodopsinës ulet në mënyrë dramatike. Kjo sëmundje quhet verbëria e natës, sepse është e dukshme vetëm në errësirë ose gjatë natës dhe nuk ndikon në shikimin gjatë ditës, për shkak të zvogëlimit të dritës për shikimin e duhur. Sidoqoftë, në dritën e diellit, konet mund të stimulohen pavarësisht nga një rënie e ngjashme e pigmenteve me ngjyra. Verbëria e natës zakonisht shfaqet vetëm te njerëzit që kanë një dietë të ulët të vitaminës A, sepse rezerva të mëdha të vitaminës A zakonisht ruhen në mëlç për t'u përdorur nga sytë.

Retina njerëzore përmban 400,000 qeliza

të cilat perceptojnë dritën për milimetër katror. Për krahasim, ky numër është 680,000 në retinë e bufit, i cili duhet të perceptojë edhe shkëlqimin më të ulët të dritës gjatë gjuetisë së natës. Si një shembull tjetër, me 397,000 qeliza të tilla në retinë e maceve është pothuajse e njëjtë me atë të njeriut.

Një mesatare prej 130 qelizash të syrit në retinë janë të lidhura me një qelizë ganglioni (nyja nervore). Duke formuar nervin e syve, ose nervin optik (nervus opticus), çdo fibër nervore është e lidhur me një qelizë ganglionare. Duhet rreth 15-60 sekonda për nervin optik të retinës që të përshtatet nga errësira në dritë, ndërsa zgjat 30-45 minuta për t'u përshtatur nga drita në errësirë. Gama vizuale e qelizave optike, domethënë sasia më e ulët dhe më e lartë e dritës që syri mund të perceptojë, është midis 10⁻⁷ dhe 10⁶ nanometër. Dritë që është nën ose mbi këto valë është e padukshme për ne për shkak të gjatësisë së saj të pamjaftueshme ose shumë të dendur.

Të gjitha ngjyrat që shohim në botë emërtohen sipas gjatësisë së valëve të thithura dhe të reflektuara nga qelizat optike. Spektri i qelizave optike shtrihet në mes së kuqes dhe vjollcës, që është kufiri i dritës së dukshme për njerëzit. Drita me një gjatësi vale prej 400 nm perceptohet si vjollcë, ndërsa drita me një gjatësi vale prej 760 nm perceptohet si e kuqe. Sytë tanë nuk mund të shohin dritën infra të kuqe dhe ultravjollcë. Megjithatë, disa kafshë njihen për aftësinë për të parë dritën përtej këtyre kufijve. Për shembull, ne e dimë se bletët mund të shohin valë të caktuara të dritës ultravjollcë, që i ndihmon ato të gjejnë lule për të thithur polenin.

Është e qartë se nuk është një punë e lehtë për të përpunuar Artin Hyjnor që shfaqet në një zonë aq të vogël sa retina. Strukturat e komplikuar dhe reaksionet që kërkohen për shikimin edhe për të kuptuar këtë artikull vazhdojnë të zhvillohen pa ndalim në çdo moment që shikojmë përreth. Të paktën mund të jemi mirënjohës për këtë dhuratë të mahnitshme të shikimit që na është dhënë falas, në mënyrë që ne të mund ta njohim universin që na rrethon.

Përktheu: Erion Sukaj

NDRYSHIMI I NIJETIT

Një burrë

"Dhe prej skajit më të largët të qytetit erdhi një njeri(burrë) që ngutej e tha: - O populli im, dëgjoni të dërguarit. Dëgjoni ata që nuk kërkon prej jush ndonjë shpërblim dhe janë udhërrëfyes. E ç'kam unë që të mos e adhuroj Atë që më krijoi e tek Ai kthehem. A të pranoj zota të tjerë përpos Tij, e nëse Mëshiruesi do të më godasë me ndonjë të keqe, ndërmjetësimi i tyre nuk do të më vlejë asgjë, e as që do të më shpëtojnë. Atëherë unë do jem në një humbje të dukshme. Unë i kam besuar Zotit tuaj, pra më dëgjoni."

Kjo është përgjigja e arsyes së shëndoshë ndaj thirrjes së drejtë të së vërtetës. Ajo ka sinqeritet, modesti, energji, drejtësi, perceptim dhe plotësim të ritmit të fortë të së vërtetës së ruajtur.

Ky është një burrë që kishte dëgjuar thirrjen dhe i ishte përgjigjur pasi ishte bindur nga argumentet e të vërtetës dhe logjikës. Kur zemra përjetoi të vërtetën e besimit, nxitim ndjenjat e tij, aq sa s'mund të heshte e të fshihte besimin, pasi shihte përreth vetes humbje, refuzim dhe anormalitet. Ai vrapoi pas së vërtetës që u rrënjos në ndjenjat dhe që zgjoi ndërgjegjen e tij. Ai bëri përpjekje mes popullit të tij, që ishte refuzues e kërcënues. Ai erdhi prej skajit më të largët të qytetit me nxitim për të kryer

obligimin e tij; thirrje drejt së vërtetës, të pengojë të keqen dhe armiqtësinë ndaj të dërguarve.

Ndryshimi i nijetit

Tregohet se një burrë dëgjoji se disa njerëz adhuronin një pemë në vend të Zotit. I revoltuar nga kjo që dëgjoji ai rrëmbeu sëpatën dhe u nis drejt pemës që ta priste. Në rrugë iu shfaq shejtani me pamjen e një burri të moshuar. Ai u mundua ta devijonte nga rruga me një sërë formash, por nuk po korrte sukses. Përkundrazi, burri e kapi fort prej gryke dhe e shtriu të moshuarin përdhe. Këtë herë shejtani i kërkoi ta lëshonte pasi i premtoi diçka joshëse. Çdo ditë në mëngjes ai do t'i dhuronte dy napolona flori.

Besimtari hyri në mendime të thella, por më në fund pranoi. Të nesërmen, me t'i dalë gjumi, futi dorën poshtë jastëkut dhe sytë i shkëlqyen kur gishtat i prekën napolonat e floririt. E njëjta gjë edhe ditën e dytë. Por, ditën e tretë nuk i gjeti napolonat. Gjithë inat brofi nga shtrati, rrëmbeu sëpatën dhe u nis drejt pemës. Në rrugë i doli përsëri shejtani me pamjen e atij plakut të moshuar, që kishte takuar herën e parë.

Këtë herë u mundua ta mundte, por nuk e mundi dot. Herën e parë, zemërimi ishte për hir të Zotit dhe Ai i dha forcë. Ndërsa herën e dytë zemërimi ishte për hir të floringjeve, ndaj nuk ngadhënjeu dot.



Një traditë e bukur

Një person tregon: Bashkë me një mikun tim hymë në një kafene të vogël. Pasi bëmë porosinë u nisëm drejt tavolinës. Ndërkohë, dy burra që sapo u futën, iu drejtuan banakierit me këto fjalë: - Pesë kafe, ju lutem. Dy për ne dhe tre rezervë. Pasi bënë pagesën morën kafetë dhe u larguan. Unë e pyeta mikun tim: Çfarë janë këto kafe rezervë? - Prit dhe do ta shohësh. - u përgjigj ai.

Në kafene u futën disa persona të tjerë. Ata porositën shtatë kafe, tre për veten dhe katër rezervë. Bënë pagesën dhe u larguan. Ndërkohë që po mendoja se çfarë janë këto kafe rezervë, po shijoja nga dritarja ditën e bukur me diell.

Pas pak, derën e kafenesë e hapi një burrë i veshur me rroba të vjetra dhe që të jepte përshtypjen e një lypsari. Ai i drejtohet me shumë mirësjellje banakierit: - A keni ndonjë kafe të rezervuar?

Pra është shumë e thjeshtë. Njerëzit paguajnë përpara një kafe, me dëshirën dhe qëllimin e mirë, që dikush i cili nuk ka mundësi të paguajë, të mos privohet nga kafeja e ngrohtë e mëngjesit.

Kjo traditë nisi si fillim në Nepal, por tani po gjen shtrirje në mbarë botën. Madje në disa vende nuk paguhet thjesht një kafe, por dhe një sanduiç apo një vakt i tërë.

Dorëzohani fëmijëve çelësat e suksesit

Dorëzohani fëmijëve çelësat e besimit të vetja, të sinqeritetit dhe të të folurit drejt. Asgjë tjetër nuk e nxit gënjeshtërinë dhe dinakërinë siç e nxit dhuna, dajaku dhe ashpërsia. Pasojat e dhunës janë aventurat e rrezikshme, nëse fëmijët kanë personalitet të fortë, ose dorëzimi dhe mbyllja në vetvete nëse janë të dobët personalisht.

Dorëzohani fëmijëve çelësat e suksesit duke i udhëzuar dhe orientuar me qetësi, me biseda miqësore, marrëdhënie të ngushta, durim të madh, fjalë të mençura, të cilat do i shoqërojnë si melodi për sa të jenë gjallë. Mos mendoni se zemërimet e herëpashershme dhe mëria e zgjatur në kohë janë zgjidhje. E çfarë vlere ka nëse e bëjnë diçka siç thonë ju, ndërkohë që e urrejnë me gjithë zemër e shpirt.

Një ditë do e shohin veten të lirë si të duan. Le të jetë munda ynë më e madhe e fokusuar në kultivimin e dashurisë për fenë, sinqeritetin, punën, vlerat morale, urrejtjen për ligësinë, injorancën, plogështinë, anarkinë, etj.

Të kultivosh në zemrat e tyre të vogla dashurinë për namazin nuk është më pak sesa ta kryejnë atë. T'i edukojmë me urrejtjen për gënjeshtërinë dhe vjedhjen, nuk është më pak se qëndrimi larg tyre.

Lutuni për fëmijët tuaj, se lutjet e mira nga ana e prindërve kanë më shumë mundësi të pranohen dhe t'u hapen portat e qiellit.

Haxhi 5800€



KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË ORGANIZON HAXHIN 2023

PËRFSHIHEN:

- ✓ Transporti ajror vajtje-ardhje.
- ✓ Transporti me autobus në Mekë dhe Medine.
- ✓ Akomodimi në hotele.
- ✓ Ushqimi: Mëngjes, drekë, darkë.
- ✓ Kurbani, ujë zemzemi, numra telefoni.
- ✓ Shoqërimi nga teologë dhe mjekë përgjatë gjithë ritualit.

DOKUMENTET E NEVOJSHME:

- ✓ Pasaporta e vlefshme jo më pak se 1 vit. Ndërsa personat që nuk kanë nënshtetësi shqiptare, duhet të paraqesin lejen e qëndrimit, me afat vlefshmërie jo më pak se 6 muaj.
- ✓ Fotografi pasaporte.
- ✓ Vaksina kundër meningjitit, me afat jo më pak se 10 ditë dhe jo më shumë se tre vjet.

REGJISTROHUNI PRANË KMSH-SË OSE PRANË MYFTINISË SË QYTETIT
TUAJ DERI MË **07 MAJ 2023**



Rr. "George.W. Bush"
Nr. 50, Tirana/Albania



www.kmsh.al
haxhi@kmsh.al



+355 696801100